



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit me Karakter Profesional në: “Teknik i Lartë” me
profile: “Sisteme Kompjuterike”, “Teknologji Informacioni dhe
Komunikimi”, “Grafik, Web dhe Multimedia Dizajn”**

ofruar nga

Kolegji Universitar “I Biznesit”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. As. Dr. Evis Trandafili

Dr. Edra Fresku

Nëntor/2025

Tabela Përmbledhëse me të dhënat për programin e studimit me karakter profesional në: “Teknik i Lartë” me profile: “Sisteme Kompjuterike”, “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, “Grafik, Web dhe Multimedia Dizajn”.

1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar “I Biznesit”			
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Studimeve të Larta Teknike			
3	Emërtimi i programit të studimit:	“Teknik i Lartë” me profile: “Sisteme Kompjuterike”, “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, “Grafik, Web dhe Multimedia Dizajn”			
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMAS nr. 343, datë 06.07.2023			
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	UMAS nr. 343, datë 06.07.2023			
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-			
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	Akreditohet për herë të parë			
8	Cikli i studimit:	Diplomë Profesionale			
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite akademike (katër semestra)			
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite			
11	Forma e studimit:	Me kohë të Plotë			
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqipe			
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-			
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-			
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-			
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 5 (pestë)			
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Viti akademik	PAE	PAK	Profili
		2023-2024	6	2	SK / TIK / GWMD
		2024-2025	10	6	SK / TIK
		2024-2025	10	5	GWMD
18	Numri i studentëve:	V.A. 2023-2024: 25 studentë			
		V.A. 2024-2025: 24 studentë			
		V.A.	SK	TIK	GWMD
		2023-2024	5 studentë	12 studentë	7 studentë
		2024-2025	9 studentë	15 studentë	0 studentë
19	Komente / të tjera:	-			

PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Kolegji Universitar i Biznesit" (KUB) është një institucion arsimor privat, i pavarur dhe laik i Arsimit të Lartë në Shqipëri, i licencuar për herë të parë në vitin 2011 nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës me VKM Nr. 651, datë 14.09.2011. KUB është riorganizuar me UMAS Nr. 165, datë 16.04.2024. Me këtë urdhër është hapur njësia e re kryesore "Fakulteti i Inxhinierisë dhe Shkencave Kompjuterike" dhe janë riorganizuar fakultetet: Fakulteti i Drejtësisë dhe Shkencave Politike dhe Fakulteti i Ekonomisë në "Fakulteti i Ekonomisë, Drejtësisë dhe Shkencave Sociale". Statuti i ri është miratuar me UMAS Nr. 567, datë 12.11.2024. Akreditimi i fundit i KUB është realizuar me VBA Nr. 03, datë 07.01.2022 me kohëzgjatje 4 vite, vlefshmëri deri më 06.01.2026. Aktualisht KUB është në proces akreditimi periodik institucional. Kolegji Universitar i Biznesit përbëhet nga 2 (dy) fakultete dhe 1 (një) Kolegj i Studimeve të Larta Profesionale.


Programi i studimit profesional "Teknik i Lartë" me profile "Sisteme Kompjuterike", "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi", "Grafik, Web dhe Multimedia Dizajn", në gjuhën shqipe, 120 ECTS, me kohëzgjatje normale 2 vjetore, ofrohet nga KUB sipas urdhërit të riorganizimit të programit profesional "Teknik i Lartë", me profile "Sisteme Motorike", "Sisteme Elektrike" dhe "Sisteme Kompjuterike", në "Teknik i Lartë", me profile "Sisteme Kompjuterike", "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" dhe "Grafik, Web dhe Multimedia Dizajn", nr. 343, datë 06.07.2023, lëshuar nga UMAS. Programi akreditohet për herë të parë.

Ky program ofrohet nga Departamenti i Studimeve të Larta Teknike, njësi bazë e Kolegjit të Studimeve të Larta Profesionale, hapur me UMASR Nr. 139, datë 23.03.2018.

Objektivi kryesor i programit profesional "Teknik i Lartë", me profile "Sisteme Kompjuterike", "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" dhe "Grafik, Web dhe Multimedia Dizajn", është të përgatisë "Teknikë të Lartë" në shkenca kompjuterike, teknologji informacioni dhe komunikimi dhe grafik, web dhe multimedia dizajn, marrjen dhe aplikimin e njohurive të duhura në praktikë.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Në përputhje me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 109/2017, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) ka caktuar kohën dhe grupet për vlerësimin e jashtëm të programit të studimit profesional "Teknik i Lartë", me profile "Sisteme Kompjuterike", "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" dhe "Grafik, Web dhe Multimedia Dizajn" në Kolegjin Universitar të Biznesit. Procesi i vlerësimit është zhvilluar bazuar në Urdhrin nr. 50,



datë 07.05.2025, me numër protokolli 97/6 të Autoritetit të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, për përcaktimin e ekspertëve për procesin e akreditimit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) përbëhet nga Prof. As. Dr. Evis Trandafili dhe Dr. Edra Fresku me asistencën e Koordinatorës Teknike të ASCAL, Znj. Alma Arapi.

Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i përgatitur nga Kolegji Universitar “I Biznesit” në Prill 2025, ka shërbyer si burimi kryesor i informacionit për GVJ-në, duke ofruar një analizë të detajuar mbi strukturat dhe mekanizmat e cilësisë të përdorura nga institucioni për menaxhimin dhe përmbushjen e objektivave akademike. Përveç raportit të brendshëm, universiteti ka ofruar një gamë të gjerë dokumentesh mbështetëse përmes sistemit të menaxhimit të cilësisë, të mundësuar nga ASCAL.

Procesi i vlerësimit është bazuar në ligjin nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore të nxjerra prej tij. Këto përfshijnë VKM-në nr. 531, datë 11.09.2018, për Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë dhe VKM-në nr. 41, datë 24.01.2018, për elementët e programeve të studimit, si dhe ndryshimet përkatëse të bëra më vonë.

Takimet për vlerësimin u zhvilluan më 26.05.2025 dhe 27.05.2025, sipas një programi të miratuar nga ASCAL. Gjatë këtyre takimeve, GVJ-ja zhvilloi diskutime intensive me përfaqësues të Kolegjit Universitar të Biznesit, duke përfshirë Dekanin e Fakultetit të Inxhinierisë, Informatikës dhe Arkitekturës, Përgjegjësin e Departamentit të Informatikës dhe Teknologjisë, stafin akademik, studentët, si dhe përfaqësues nga njësitë e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe kurrikulave.

Gjatë procesit, grupi kreu edhe vizita në auditorë, laboratorë dhe bibliotekë, për të shqyrtuar infrastrukturën dhe mbështetjen teknike të ofruar për programin. Analiza e programit u përqendrua në vlerësimin e strukturës së tij, përmbajtjes së syllabusit, objektivave të të mësuarit, kompetencave të synuara, metodave të mësimdhënies

dhe materialeve mësimore. Gjithashtu, u shqyrtuan mënyrat e vlerësimit të dijeve, përcaktimi i krediteve akademike dhe kualifikimet e stafit akademik.

Në përfundim të vlerësimit, GVJ-ja përgatiti një raport që paraqet një analizë gjithëpërfshirëse të programit të studimit, duke përfshirë rekomandime për përmirësimin e cilësisë dhe efikasitetit të tij. Ky raport synon të ndihmojë Kolegjin Universitar të Biznesit të forcojë pikat e forta dhe të adresojë sfidat e identifikuara në mënyrë që të përmbushë standardet më të larta të arsimit të lartë.

Kolegji Uiversitar “I Biznesit”, është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 27.10.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 97 / 22 Prot, datë 27.10.2025. Kolegji Universitar “I Biznesit”, njofton në ASCAL më datë 03.11.2025, me anë të shkresës me Nr.598 Prot, datë 03.11.2025 “Kthim përgjigje për Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm për programin e studimit”, IAL përcolli komentet me shkresë zyrtare Nr. 598 Prot, Datë 03.11.2025.



Tek Standardi I.1, Kriteri 3, rekomandohet azhurnimi i rregullores së programit të studimit TL sipas profileve të reja dhe Standardi II.3, Kriteri 1 rekomandohet azhurnimi/hartimi i rregulloreve të KSLP, DSLT dhe të programit sipas profileve të reja të programit profesional të riorganizuar. Gjatë vizitës në institucion janë kërkuar si evidenca shtesë rregulloret e azhornuara sipas profileve të reja, por rezulton se **në dokumentacionin shtesë të dërguar nga institucioni në sitemin e ASCAL mungojnë rregulloret e azhornuara, prandaj nuk ka ndryshime në kriteret e vlerësuar.**

Tek Standardi I.1, Kriteri 3, duke qenë se GVJ konstaton një **analizë të përgjithshme dhe jo të detajuar për programin e studimit** rekomandohet realizimi i raporteve periodike analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në mënyrë **më të detajuar specifikisht për programin e studimit**, prandaj **nuk ka ndryshime në kriterin e vlerësuar dhe konkluzionet përkatëse.**



Tek Standardi II.1, Kriteri 1, *sugjerohet përfshirja e tipologjisë së lëndës (A, B, C, D, E) aty ku konstatohet se mungon*, pra në Planin mësimor dhe jo në Kurrikulën e programit të studimit, prandaj **nuk ka ndryshime në kriterin e vlerësuar dhe konkluzionet përkatëse.**

Tek Standardi II.1, Kriteri 6, GVJ gjatë vizitës në institucion ka kërkuar evidencë shtesë që të justifikojë përmbushjen ngjashmërisë së përmbajtjes me programe të tjera të fushës në masën së paku 70 %, por rezulton se mungon një evidencë e tillë **në dokumentacionin shtesë të dërguar nga institucioni në sitemin e ASCAL**, prandaj **nuk ka ndryshime në kriterin e vlerësuar.**

Tek Standardi II.1, Kriteri 7, në evidencën e kodifikimit profili Sisteme Kompjuterike e ka kodin 52PP0612S, ndërkohë që 2 (dy) nga profilet e programit nuk pasqyrohen, GVJ rekomandon që kodifikimi i programit të studimit profesional me profile të kryhet në nivel programi studimi sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane (VKM. 310, datë 11.05.2022), prandaj **nuk ka ndryshime në kriterin e vlerësuar.**

Tek Standardi II.2, Kriteri 2, pas një analize të hollësishme rekomandohet t'i kushtohet vëmendje përmbushjes së Vendimit të MASR nr.418, datë 10.5.2017, pika 2.b.ii, për mbulimin e ngarkesës mësimore minimalisht 70% nga staf PAE, pikërisht **duke patur një vëmendje të shtuar dhe marrje masash në rastin e largimit të stafit PAE gjatë vitit akademik**, prandaj **nuk ka ndryshime në kriterin e vlerësuar.**

Tek Standardi II.2, Kriteri 3, *sugjerohet të caktohet një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit*, i cili do të jetë përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e programit **për të minimizuar ngarkesën e Përgjegjës të Departamentit që mbulon 3 programe studimi profesionale me nga 3 profile secili**, prandaj **nuk ka ndryshime në kriterin e vlerësuar dhe konkluzionet përkatëse.**



Tek Standardi II.3, Kriteri 4, tek kolona “Ngarkesa e Lëndëve”, në Planin mësimor të profilit SK, viti I-rë rezulton:

Ngarkesa e Lëndëve				
Gjithsej	Leksione	Seminare	Laboratore	Kontroll i ndërmjetëm
600	272	174	85	19
600	550			

Kjo për arsye të përfshirjes së ngarkesës së Praktikës Profesionale tek kolona *Gjithsej* dhe mospërfshirja e saj në kolonat specifike, prandaj rekomandohet të shtohet kolonë për Praktikën Profesionale si më poshtë:

Ngarkesa e Lëndëve					
Gjithsej	Leksione	Seminare	Laboratore	Kontroll i ndërmjetëm	Praktike Profesionale
600	272	174	85	19	50
600	600				

Ky rekomandim vlen për të tre profilet dhe **nuk ka ndryshime në kriterin e vlerësuar.**

Tek Standardi II.3, Kriteri 4, GVJ ka bërë një analizë të detajuar në lidhje me rekomandimin e dhënë, prandaj **nuk ka ndryshime në kriterin e vlerësuar.**

Tek Standardi II.4, Kriteri 2, rekomandohet që Provimi Formimi (60 orë në auditor) të kalojë orë e individuale e studentit duke qenë se shlyhet me provim, nuk ka një ngarkesë të shpërndarë në staf akademik dhe nuk ka syllabus. Gjatë vizitës në institucion është kërkuar evidencë shtesë për Fondin e Pyetjeve të Provimit të Formimit dhe syllabusin përkatës. Institucioni nuk ka dorëzuar në sistemin e ASCAL një dokumentacion të tillë, prandaj **nuk ka ndryshime në kriterin e vlerësuar.**


Tek Standardi II.4, Kriteri 4, rekomandohet që DSLT të punojë për rritjen e mobiliteteve në kuadër të bashkëpunimeve në projekte Erasmus+ që lidhen ngushtë me fushën e këtij programi studimi (Tabela 20). Në kundërshtim me analizën e KUB, në një program profesional universitar nuk i hiqet mundësia e *aplikimit dhe regjistrimit një studenti me mesatare më të lartë se 6.5* si dhe sipas ASCAL, bazuar në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore, testi i gjuhës së huaj hartohet në përputhje me gjuhën, e cila në planin mësimor trajtohet si gjuhë e huaj e parë dhe niveli i njohurive synohet të jetë B2, sipas “Kuatrit të Përbashkët European të Referencave për Gjuhët”, duke mos penalizuar kështu mundësinë e pjesëmarrjes në mobilitete ERASMUS+, prandaj **nuk ka ndryshime në kriterin e vlerësuar.**

Tek Standardi II.4, Kriteri 6, rekomandohet hartimi i një **pakete për Praktikën Profesionale për programin e studimit TL sipas profileve SK, TIK dhe GWMD** në harmoni me rregulloret institucionale të IAL-së, duke qenë se GVJ ka konstatuar ekzistencën e një

rregulloreje Praktike Profesionale në rang fakulteti dhe jo programi studimi, prandaj nuk ka ndryshime në kriterin e vlerësuar.

Tek Standardi II.5, Kriteri 6, GVJ thekson se mungon evidencë për krijimin dhe funksionimin e Bordit të Këshillimit të Karrierës, dokumentacion që është kërkuar edhe pas vizitës në institucion si evidencë shtesë dhe nuk është ngarkuar nga KUB në sistemin e ASCAL, prandaj **nuk ka ndryshime në kriterin e vlerësuar.**

Tek Standardi III.6, Kriteri 2, rekomandimi i GVJ lidhet me procedurën që përmendet në RVB për vlerësimin e aftësive mësimdhënëse të stafit akademik nëpërmjet ndjekjes së orëve të caktuara mësimore. Komenti i institucionit, nga ana tjetër, lidhet me pyetëtorët e studentëve referuar Rregullores së KUB Neni 113-116 dhe Rregullores KSLP Neni 61. Pra, kemi të bëjmë më dy gjera të ndryshme. GVJ gjykon që **kriteri i vlerësuar nuk ndryshon.**




Vlerësimi i Programit të studimit me karakter profesional në: “Teknik i Lartë” me profile: “Sisteme Kompjuterike”, “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, “Grafik, Web dhe Multimedia Dizajn”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga Kolegji Universitar “I Biznesit” (KUB), GVJ konstaton se në misionin e tij, IAL ka për qëllim të krijojë, transmetojë, zhvillojë dhe të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor; të formojë specialistë të lartë dhe të përgatisë shkencëtarë të rinj; të mbështesë zhvillimin kulturor e social-ekonomik në nivel rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar. Në planin strategjik KUB është i angazhuar në edukim, kërkim shkencor, zhvillim stafi dhe jetë studentore, përmirësim cilësie në shërbime dhe infrastrukturë. Evidencë Dok 17 Statuti i KUB.pdf Evidencë Dok 11 Planet strategjike të zhvillimit të IAL Kolegji Universitar i Biznesit.pdf
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit “Teknik i Lartë” me profilet “Sisteme Kompjuterike”, “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, “Grafik, Web dhe Multimedia Dizajn” ofrohet në përputhje me misionin dhe qëllimet e institucionit. Në zbatim të misionit, objektivave dhe drejtimeve akademike të tij, KUB ka për qëllim zhvillimin e arsimit, kulturës, shkencës dhe ekonomisë, në shërbim të lirisë dhe diversitetit të ideve, si dhe të përgatisë specialistë që përmbushin kërkesat e tregut shqiptar dhe ndërkombëtar të punës. Gjithashtu ky program është hartuar në përputhje me Kornizën Shqiptare dhe atë Evropiane të Kualifikimeve, të bazuara në kërkim e inovacion si dhe të lidhura ngushtë me praktikën e aplikimin, për të përgatitur specialistë dhe ekspertë të mirëformuar. Evidencë Dok 17 Statuti i KUB.pdf Evidencë Dok 11 Planet strategjike të zhvillimit të IAL

	Kolegji Universitar i Biznesit.pdf
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Programi i studimit ofrohet në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit. Objektivi kryesor i programit të studimit është të përgatisë specialistë Teknikë të Lartë në shkenca kompjuterike, teknologji informacioni dhe komunikimi dhe grafik, web dhe multimedia dizajn, marrjen dhe aplikimin e njohurive të duhura në praktikë. Gjithashtu synon t'i mundësojë studentëve një formim më të thelluar në këto profile dhe t'i përgatisë për tregun e punës në sektorin publik dhe atë privat. Programi i studimit me 2 (dy) vite akademike është i organizuar si "Program Profesional", në respektim dhe zbatim të Ligjit të Arsimit të Lartë nr. 80/2015 dhe zhvillohet në përputhje me rregullat dhe parimet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë, Statutin e KUB dhe aktet e brendshme rregullatore të tij. Ky program studimi është organizuar në 120 kredite ECTS sipas nivelit 5 të kornizes kombëtare të kualifikimev. GVJ konstaton që rregullorja e programit të studimit nuk është azhurnuar pas procesit të riorganizimit të programit të studimit nga "Teknik i Lartë", me profile "Sisteme Motorike", "Sisteme Elektrike" dhe "Sisteme Kompjuterike" në "Teknik i Lartë" me profilet "Sisteme Kompjuterike", "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi", "Grafik, Web dhe Multimedia Dizajn" sipas UMAS nr. 343, date 06.07.2023 dhe <u>GVJ rekomandon azhurnimin e rregullores së programit të studimit TL sipas profileve të reja.</u> Evidencë Dok 17 Statuti i KUB.pdf Evidencë Dok 11 Planet strategjike të zhvillimit të IAL Kolegji Universitar i Biznesit.pdf Evidencë Dok 10 Rregullore e programit të studimit "Teknik i Lartë".pdf
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet mbështetur në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe.	Përmbajtja e programit të studimit jep mundësi të mëtijshme studimi dhe punësimi të studentëve në përputhje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës. Evidencë Dok.34. Kurrikula dhe planet mësimore të programit "Teknik i Lartë".pdf Evidencë Dok.35. Kurrikula e Programit të studimit "Teknik i Lartë" me profilet "Sisteme Kompjuterike".pdf Evidencë Dok.36 Planet mësimore për vitin akademik , 2023-2024 dhe 2024-2025.pdf Evidencë Dok.12, Studim i Tregut të Punës për programin e




	studimit “Teknik i Lartë”.pdf Evidencë Dok 81 Raport i studimit të tregut nga ZSKK.pdf																								
Kriteri 5. Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	KUB është një institucion jopublik i arsimit të lartë i cili ka nisur ushtrimin e aktivitetit të tij me Vendim të Këshillit të Ministratve nr. 651, datë 14.09.2011, si Akademia Profesionale e Biznesit. Njësitë kryesore të KUB janë: - Fakulteti i Inxhinierisë dhe Shkencave Kompjuterike - Fakulteti i Ekonomisë, Drejtësisë dhe Shkencave Sociale - Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale (KSLP) KSLP ka në përbërje të tij: - Departamenti i Studimeve të Larta Administrative - Departamenti i Studimeve të Larta Teknike (DSLTP) DSLTP është përgjegjës për programin e studimit profesional “Teknik i Lartë” me profilet “Sisteme Kompjuterike”, “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, “Grafik, Web dhe Multimedia Dizajn”. Angazhimi i stafit akademik në programin e studimit sipas dy viteve të fundit akademike është si më poshtë vijon: <table><tr><th>Viti akademik</th><th colspan="2">PAE</th><th colspan="2">PAK</th><th>Profili</th></tr><tr><td>2023-2024</td><td>5</td><td>1-Dr. 4-Msc.</td><td>3</td><td>3-Msc.</td><td>SK / TIK / GWMD</td></tr><tr><td>2024-2025</td><td>11</td><td>3-Dr. 1-Dr.c. 7-Msc.</td><td>5</td><td>5-Msc.</td><td>SK / TIK</td></tr><tr><td>2024-2025</td><td>11</td><td>3-Dr. 1-Dr.c. 7-Msc.</td><td>4</td><td>4-Msc.</td><td>GWMD</td></tr></table> Nga shqyrtimi i tabelës nr. 6.1, evidencës 13, 40, 60 dhe CV të stafit, GVJ konstaton që L.Reci, gjatë vitit akademik 2023-2024, nuk është e aktivizuar si staf akademik. Gjithashtu, bazuar në tabelën nr. 6.2, evidencë 13, 40, 60 rezulton se J. Pelivani, gjatë vitit akademik 2023-2024, është e aktivizuar	Viti akademik	PAE		PAK		Profili	2023-2024	5	1-Dr. 4-Msc.	3	3-Msc.	SK / TIK / GWMD	2024-2025	11	3-Dr. 1-Dr.c. 7-Msc.	5	5-Msc.	SK / TIK	2024-2025	11	3-Dr. 1-Dr.c. 7-Msc.	4	4-Msc.	GWMD
Viti akademik	PAE		PAK		Profili																				
2023-2024	5	1-Dr. 4-Msc.	3	3-Msc.	SK / TIK / GWMD																				
2024-2025	11	3-Dr. 1-Dr.c. 7-Msc.	5	5-Msc.	SK / TIK																				
2024-2025	11	3-Dr. 1-Dr.c. 7-Msc.	4	4-Msc.	GWMD																				

	si staf akademik me kontratë. Ndërsa në vitin akademik 2024-2025 të dy pedagoget aktivizohen si staf akademik me kohë të plotë. Bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë nr.80, 2015, Neni 59, pika 6 thuhet se: - Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës. <u>GVJ konstaton angazhimin e personelit akademik në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</u> Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga IAL në lidhje me formimin e personelit akademik të DSLT, CV-të, GVJ vlerëson se plotësohen kapacitetet akademike për ofrimin e këtij programi studimi. Evidencë Dok 18 Rregullore e KUB_11zon.pdf Evidencë shtesë 2.Tabela permbledhese RVB TL_ LR.pdf Evidencë shtesë CV (Stafi TLSKTIKGWMD).pdf Evidencë Dok 13 Lista e plotë e personelit të KUB 2023-2024 dhe 2024-2025.pdf Evidencë Dok 40 Lista e stafit akademik të DSLT, tituj grada.pdf Evidencë Dok 60. Lista e stafit dhe Ngarkesa Vjetore e Stafit Akademik të Programit “ Teknik i Lartë”.pdf
Kriteri 6. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga GVB, që i referohet Statutit të KUB dhe rregulloreve në tërësi rezulton se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit është në përputhje të plotë me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore KSLP, përgjegjëse për këtë program e studimi. Programi i studimit është kodifikuar me kodin: 52PP0612S, bazuar edhe në klasifikimin/kodifikimin e programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane (VKM. 310, datë 11.05.2022). Gjithashtu, konstatohet se DSLT është njësi bazë e KSLP që e ofron këtë program studimi dhe e zhvillon veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përmbushje të standardeve të cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. Programi i studimit (120 ECTS) me dy vite akademike është konceptuar në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë që është përgjegjëse për këtë program studimi. <i>Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë dhe në përputhje me kërkesat e VKM-së nr.41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve ...”, i</i>






	<i>ndryshuar.</i> Evidencë Dok 17 Statuti i KUB.pdf Evidencë Dok 18 Rregullore e KUB_11zon.pdf Evidencë Dok 10 Rregullore e programit të studimit “Teknik i Lartë”.pdf Evidencë Dok 8 Lista e programeve në KSLP.pdf Evidencë Dok 39 Shkresa e kodifikimit të programit “Teknik i Lartë.pdf			
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-6 të standardit I.1, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se:</i> - <i>KUB ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.</i> - <i>Programi i studimit ofrohet në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</i> - <i>Përmbajtja e programit të studimit jep mundësi të mëtijshme studimi dhe punësimi të studentëve në përputhje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës.</i> - <i>Angazhohet personel akademik në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</i> - <i>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit është në përputhje të plotë me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore KSLP, përgjegjëse për këtë program e studimi.</i> - <i>Rregullorja e programit të studimit nuk është azhornuar pas procesit të riorganizimit të programit të studimit nga "Teknik i Larte", me profile "Sisteme Motorike", "Sisteme Elektrike" dhe "Sisteme Kompjuterike" në "Teknik i Lartë" me profilet "Sisteme Kompjuterike", "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi", "Grafik, Web dhe Multimedia Dizajn".</i> <u><i>GVJ rekomandon:</i></u> - <i>azhornimin e rregullores së programit të studimit konform UMAS nr. 343, date 06.07.2023</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit GJV konstaton se KUB siguron bashkëpunimin dhe realizon ndarjen e detyrave mes njësive e personelit në rregulloret respektive, si dhe ndjekjen e zbatimit të tyre. Nga vlerësimi rezulton se DSLT menaxhon dhe drejton me efektivitet programin profesional i cili ka një kohëzgjatje 2-vjeçare dhe në total përmban 120 kredite. GJV konstatoi që ndarja e detyrave, vendimmarrja dhe llogaridhënia janë të harmonizuara në aktet rregullatore të institucionit. Njësia bazë ka peshën kryesore për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit të studimit. Përcaktimi i koordinatorit të programit të studimit është një element i rëndësishëm që lidhet ngushtësisht me këtë peshë. GJV konstaton se institucioni e mbikëqyr mbarëvajtjen e programit të studimit me analiza të vazhdueshme të punës së bërë brenda fakultetit duke nxitur dhe mbështetur një marrëdhënie eficiente bashkëpunimi midis gjithë aktorëve në vazhdimësi. Evidencë Dok 14. Rregullore e KSLP.pdf Evidencë Dok 15. Rregullore e DSLT.pdf Evidencë Dok 16. Organigrama e KUB.pdf Evidencë Dok 17 Statuti i KUB.pdf Evidencë Dok 18 Rregullore e KUB_11zon.pdf Evidencë Dok 29 Raporti Vjetor i KUB për vitin akademik 2023-2024 dhe Raporti semestrit parë 2024-2025.pdf Evidencë Dok 23. Analizë vjetore e punës së DSLT për vitin akademik 2023-2024,.pdf
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës	Nga shqyrtimi i dokumentacionit GJV konstaton se KUB ka dorëzuar një <u>listë</u> me bashkëpunëtorë vendas dhe të huaj si dhe biznese kryesisht vendase. Gjatë vizitës në institucion GJV ka kërkuar evidencë shtesë për marrëveshjet e nënshkruara, gjë e cila nuk është plotësuar nga KUB. Prandaj, <u><i>GJV nuk është në gjendje të vlerësojë me saktësi nëse në objektet e këtyre marrëveshjeve përfshihen objektivat formues të programit të studimit TLSKTIKGWMD.</i></u>



dhe/ose të huaj.	Evidencë Dok.19 Lista e institucioneve kompanive dhe subjekteve me të cilat KUB ka marrëveshje.pdf Evidencë Dok.20 Lista e kompanive, institucioneve dhe subjekteve me të cilët DSLT ka marrëveshje.pdf
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme, afatgjata e të qëndrueshme me institucione, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës etj, dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se KUB ka dorëzuar një <u>listë</u> me marrëveshje të shumta bashkëpunimi për zhvillimin e praktikës profesionale. Gjatë vizitës në institucion GVJ ka kërkuar evidencë shtesë për marrëveshjet e nënshkruara specifikisht për programin, gjë e cila nuk është plotësuar nga KUB. Prandaj, <u>GVJ nuk është në gjendje të vlerësojë me saktësi nëse këto marrëveshje të listuara përmbushin këtë kriter.</u> Evidencë Dok.19 Lista e institucioneve kompanive dhe subjekteve me të cilat KUB ka marrëveshje.pdf Evidencë Dok.20 Lista e kompanive, institucioneve dhe subjekteve me të cilët DSLT ka marrëveshje.pdf
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Nga KUB, KSLP dhe DSLT, si pjesë e analizës vjetore të vetëvlerësimit realizohet dhe paraqitet një analizë e bashkëpunimit me aktorët e jashtëm dhe përfitimit në kuadër të procesit mësimor dhe formues. Megjithatë, GVJ konstaton një analizë të përgjithshme dhe jo detajuese për programin e studimit. <u>GVJ rekomandon realizimin e raporteve periodike analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit më të detajuar specifikisht për programin e studimit.</u> Evidencë Dok 29 Raporti Vjetor i KUB për vitin akademik 2023-2024 dhe Raporti semestrit parë 2024-2025.pdf Evidencë Dok 23. Analizë vjetore e punës së DSLT për vitin akademik 2023-2024,.pdf
Kriteri 5. Institucioni ndërmerri iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve.	Zyra e studentit dhe Këshillimit të Karrierës ndjek hap pas hapi ecurinë e studentëve të diplomuar, me qëllim ruajtjen e kontakteve dhe ofrimin e mundësive të punësimit në institucionet me të cilat KUB bashkëpunon. Evidencë Dok 24 Rregullore e ZSKK (Zyra për Këshillim të Studentit dhe Karrierën.pdf
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-5 të standardit I.2, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se:</i> - KUB siguron bashkëpunimin dhe realizon ndarjen e detyrave mes njësive e personelit në rregulloret

	respektive, si dhe ndjekjen e zbatimit të tyre. - Ndarja e detyrave, vendimmarrja dhe llogaridhënia janë të harmonizuara në aktet rregullatore të institucionit. - KUB ofron listë të zgjeruar me marrëveshje të shumta bashkëpunimi me IAL vendase dhe të huaja si dhe biznese kryesisht vendase. - Mungon evidencë për marrëveshjet e nënshkruara ndërmjet KUB dhe institucioneve të tjera për praktikën profesionale apo për arritjen e objektivave formuese të programit të studimit. - <u>GVJ rekomandon</u> realizimin e raporteve periodike analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit më të detajuar specifikisht për programin e studimit. - Zyra e studentit dhe Këshillimit të Karrierës ndjek hap pas hapi ecurinë e studentëve të diplomuar, me qëllim ruajtjen e kontakteve dhe ofrimin e mundësive të punësimit në institucionet me të cilat KUB bashkëpunon.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Gjatë vizitës në institucion dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, GVJ konstaton se KUB ka si strukturë kryesore përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC). Kjo strukturë ka në aktet e saj rregullatore Rregulloren e NJSBC. Organizimi dhe funksionimi i saj është parashikuar edhe në Statutin, Rregulloren dhe Planet Strategjike të KUB. Evidencë Dok 11 Planet strategjike të zhvillimit të IAL Kolegji Universitar i Biznesit.pdf Evidencë Dok 16. Organigrama e KUB.pdf

	Evidencë Dok 17 Statuti i KUB.pdf Evidencë Dok 18 Rregullore e KUB_11zon.pdf Evidencë Dok 25. Rregullore e Ekuivalentimit.pdf Evidencë Dok 26. Rregullore e Njsbc.pdf Evidencë Dok 27. Rregullore e provimeve.pdf
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuar një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Gjatë vizitës në institucion dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se NJSBC është strukturë e pavarur në nivel institucioni, e përbërë nga 5 anëtarë (3 PAE, 1 student dhe 1 ekspert i jashtëm) dhe ka si qëllim monitorimin, vlerësimin, zhvillimin dhe përmirësimin e veprimtarisë së KUB. Kjo njësi në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës dhe Zv/Rektorin akademik dhe marëdhëniet me studentët luajnë një rol thelbësor në përmbushjen e objektivave që ka hartuar KUB në dokumentin e Planit Strategjik për Zhvillimi Institucional 2024-2030 në lidhje me përmirësimin e cilësisë së proceseve akademike duke përqëndruar vëmendjen në: - Punësimi i të diplomuarve - Përmirësimi i kurrikulave dhe pasurimi i Bibliotekës - Mirëfunksionimi i strukturave të menaxhimit dhe organizimit në KUB - Ndërkombëtarizimi etj. Në kuadër të vlerësimit të brendshëm, konstatohet se, GVB është ngritur në përputhje me Statutin e KUB, në bashkëpunim me NJSBC dhe ka hartuar Raportin e Vlerësimit të Brendshëm në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore, dhe të bazuar në dokumentat që i janë vënë në dispozicion GVJ. Evidencë Dok.28. Vendimi i SA “Për ngritje strukturash mbështetëse dhe emërimet përkatëse në KUB”.pdf Evidencë Dok 11 Planet strategjike të zhvillimit të IAL Kolegji Universitar i Biznesit.pdf Evidencë Dok 5 Propozim për GVB me nr.114, datë 26.01.2025.pdf Evidencë Dok 78 Vendimi i Senatit për pjesëmarrjen si anëtar i Senatit i përfaqësuesit të studenteve.pdf
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve	KUB është akredituar për herë të fundit sipas Vendimit të Bordit të Akreditimit Nr. 03, datë 07.01.2022, me kohëzgjatjen prej 4 (katër) vite. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të Institucionit është 06.01.2026. Programi i studimit është riorganizuar me UMAS nr. 343, date 06.07.2023 “Për riorganizimin e Programit të studimit



të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.	me karakter profesional, nga “Teknik i Lartë” me tre profile “Sisteme Motorrike”, “Sisteme Elektrike” dhe “Sisteme Kompjuterike” në “Teknik i Lartë”, me profilet “Sisteme Kompjuterike”, “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” dhe “Grafik, Web dhe multimedia Dizajn” në KUB”. Vlerësimi i jashtëm i programit të studimit, me qëllim akreditimin e programit të studimit, po realizohet për herë të parë nga ASCAL. KUB ka një pyetësor për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit që përbëhet nga 11 pyetje të mbyllura që lidhen me mësimdhënien dhe veprimtaritë që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo indirekte me të. Evidencë Dok 2 Vendimin BA Nr. 03, datë 07.01.2022, Për akreditimin periodik institucional, të Kolegjit.pdf Evidencë Dok 4 Urdhër i Ministrit të Arsimit , Sportit dhe Rinisë Nr. 343, datë 06.07.2023 “Për.pdf Evidencë Dok 51 Raport i NJSBC për vitin akademik 2023-2024.pdf Evidencë Dok 59 Pyetësor i studentëve dhe pedagogëve nga NJSBC.pdf
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira.	NJSBC ka në kompetencat e tij hartimin e raportit vjetor të sigurimit të cilësisë. Raporti përmban informacion të diskutuar paraprakisht me të gjithë anëtarët e departamenteve, përfaqësuesit e studentëve, të ekspertëve të jashtëm, sekretarisë mësimore dhe Dekanit. KUB bazuar në instrumentat e brendshëm të saj për sigurimin e cilësisë, përcakton direktivat e zhvillimit, objektivat dhe fushat e përmirësimit dhe proceset kryesore të sigurimit të cilësisë. Ky proces i brendshëm i cilësisë përbëhet nga një procedurë ku zhvillohen aktivitete të rregullta monitoruese dhe përmirësuese. Rezultatet e vlerësimit, të cilat evidentojnë arritjet në procesin mësimor dhe kërkimor e shkencor dhe problematikat, diskutohen me palët përkatëse dhe në bazë të tyre nxirren rekomandimet që kanë si qëllim të adresojnë problematikat dhe mënyrat e zgjidhjes së tyre. Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe në takimet me stafin akademik, GVB dhe me përfaqësues nga NJSBC, konstatohet se KUB ka identifikuar tregues të qartë dhe të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim për monitorimin e standardeve të cilësisë. Evidencë Dok 51 Raport i NJSBC për vitin akademik 2023-2024.pdf

	Dok 33 Raporti i Punes Kerkimore Shkencore dhe Projekteve permbledhese per periudhen 20-24_11zon.pdf			
Konkluzione	Bazuar në analizën e kriterëve 1-4 të standardit I.3, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se për sigurimin e brendshëm të cilësisë, KUB ka ngritur struktura institucionale si NJSBC, GVB të cilat funksionojnë sipas rregulloreve të brendshme institucionale. NJSBC monitoron cilësinë e zhvillimit të procesit mësimor, mbikëqyr proceset e vlerësimit të brendshëm, raportimin në rastet e vlerësimit të jashtëm të cilësisë etj. Në mënyrë periodike, NJSBC zhvillon pyetësorë me studentët me qëllim vlerësimin e procesit akademik dhe aspekteve të tjera që lidhen me institucionin.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL


Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit me karakter profesional, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe	GVJ konstaton se struktura e programit të studimit është organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi, dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ky program studimi ka një kohëzgjatje prej 2 vitesh akademike të shpërndarë në 4 semestra (në total 120 kredite) dhe përmban të shprehura shpërndarjen e krediteve midis lëndëve, një ndarje të qartë sipas kategorive të përcaktuara në VKM Nr. 185, datë 25.3.2021, "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 41, datë 24.1.2018, "Për elementet e

Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, të ndryshuar. GVJ konstaton se përqindjet sipas secilit tip të komponentëve mësimor janë në përputhje me VKM nr. 41: • Lëndët bazë: 15%; • Lëndët karakterizuese: 51.6%; • Lëndët ndërdisiplinore: 13.4%; • Lëndët plotësuese: 15%; • Detyrimet përmbyllëse: 5%. GVJ konstaton që tipologjia e lëndës NUK paraqitet në planin mësimor i cili konsiderohet si një nga dokumentat më të rëndësishëm të programit të studimit. Gjithashtu, vërejmë dokumenti që kategorizon lëndët sipas tipologjive të kërkuara nga VKM 41 ka kontradikta si psh në programi profesional të studimit Teknik i Lartë me profil Sisteme Kompjuterike: - Lënda “Algoritmikë dhe Hyrje në Programim” konsiderohet si lëndë e kategorisë A: Lëndë Bazë/Kulturë e përgjithshme. - Lëndët “Organizim i Sistemeve Kompjuterike”, “Sistemet Web Server”, “Sistemi Windows” janë kategorizuar si lëndë Ndërdisiplinore të kategorisë C. - Lënda “Shkenca Kompjuteri” është lëndë plotësuese e kategorisë D. <i>GVJ e konsideron këtë si një parregullësi që mund të krijojë pengesa në rastin e transferimit të studimeve dhe rekomandon institucionin të bëjë më shumë kujdes në klasifikimin e lëndëve sipas kategorive A, B, C, D duke patur parasysh jo vetëm plotësimin e kësaj ligjore të VKM 41, por edhe tipologjinë dhe fushën specifike të programit të studimit. Gjithashtu, integrimi në Planin mësimor i tipologjisë (A, B, C, D, E) për secilin modul do të përmirësonte cilësinë e informacionit që mbart plani mësimor.</i> <u>GVJ sugjeron</u> përfshirjen në Planin mësimor të tipologjisë së lëndës (A, B, C, D, E) për secilin modul si dhe Praktikat Profesionale I dhe II të kenë përkatësisht ngarkesë 60 orë secila për një organizim më të mirë (3 javë; 20 orë/javë; 4 orë/ditë) si dhe për një sasi më të lartë orësh praktike duke marrë parasysh faktin se kemi të bëjmë me program studimi profesional ku praktika ka një rol thelbësor. Evidencë Dok 45 Struktura e vitit akademik për programin Teknik I Lartë, plani dhe orari mësimor.pdf Evidencë Dok.34. Kurrikula dhe planet mësimore të
--	--

	programit “Teknik i Lartë.pdf Evidencë Dok.35. Kurrikula e Programit të studimit “Teknik i Lartë” me profilet “Sisteme Kompjuterike.pdf Evidencë Dok.36 Planet mësimore për vitin akademik , 2023-2024 dhe 2024-2025.pdf Evidencë Dok 44. Syllabus i lendes “ Arkitektura e kompjuterave”, (Model sipas kërkesës së VKM)]..pdf
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve praktike në një fushë të specializuar profesionale.	Qëllimi i programit profesional Teknik i Lartë me profile me 120 kredite është të përgatisë teknikë të lartë të aftë në fushën e sistemeve kompjuterike, teknologjisë së informacionit dhe dizenjimit të faqeve web. Ky program studimi ndër të tjera ka për qëllim të formojë gjeneratën e re të profesionistëve, të cilët do të kenë njohuritë e duhura dhe eksperiencat për të zhvilluar dhe mirëmbajtur sisteme dhe aplikacione. Ai synon t’i pajisë studentët me njohuritë dhe bazat teorike, si dhe me aftësitë dhe praktikën e nevojshme në këtë fushë GVJ konstaton se ky objektivi përmbushet dhe rezultoni i shprehur qartë në syllabuset e lëndëve, por jo në rregulloren e programit të studimit e cila nuk është e përditësuar pas procesit të riorganizimit. <u>GVJ rekomandon që rregullorja e programit të studimit duhet azhornuar sipas tre profileve:</u> - Sisteme kompjuterike - Teknologji informacioni dhe komunikimi - Grafik, web dhe multimedia dizajn Evidencë Dok 10 Rregullore e programit të studimit “Teknik i Lartë”.pdf Evidencë shtesë TL GWMD SYLLABUS 24-25.pdf Evidencë shtesë TL SIST KOMPJ 24-25.pdf Evidencë shtesë TL TIK 2024-2025.pdf
Kriteri 3. Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit.	GVJ konstaton se objektivat e programit të studimit janë të përcaktuara qartë në RVB, por jo në rregulloren e programit të studimit për arsyen e shpjeguar edhe në Kriterin më lart. (Standardi II.1, Kriteri 2) <u>GVJ rekomandon që rregullorja e programit të studimit duhet azhornuar sipas tre profileve:</u> - Sisteme kompjuterike - Teknologji informacioni dhe komunikimi - Grafik, web dhe multimedia dizajn bazuar edhe në objektivat e përcaktuar qartë nga GVB në këtë kriter të RVB. Evidencë Dok 10 Rregullore e programit të studimit “Teknik i Lartë”.pdf



Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshirë dhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe vizita në institucion GJV konstaton se programi i studimit në kurrikulën e tij parashikon zhvillimin e lëndës Praktikë Profesionale I dhe II si veprimtari formuese dhe ka të përcaktuar ngarkesën totale prej 10 kreditesh, me një total prej 100 orësh në ambientin e institucionit ku do të zhvillohet praktika. Ndërsa Provimi i Formimit ka një ngarkesë prej 6 kreditesh. Evidencë Dok 45 Struktura e vitit akademik për programin Teknik I Lartë, plani dhe orari mësimor.pdf Evidencë Dok.34. Kurrikula dhe planet mësimore të programit “Teknik i Lartë”.pdf Evidencë Dok.35. Kurrikula e Programit të studimit “Teknik i Lartë” me profilet “Sisteme Kompjuterike”.pdf Evidencë Dok.36 Planet mësimore për vitin akademik , 2023-2024 dhe 2024-2025.pdf
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadër ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	NA
Kriteri 6. Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe RVB, GVB thekson se nuk ka programe të ngjashëm në të njëjtën fushë studimi. GJV gjatë vizitës në institucion, kërkoi evidencë shtesë në lidhje me përmbushjen e kriterit të ngjashmërisë së përmbajtjes me programe të tjera të fushës në masën së paku 70 %. <u>GJV konstaton se KUB nuk ka dorëzuar një evidencë shtesë që të justifikojë përmbushjen e këtij kriteri. GJV nuk mund të shprehet në lidhje me plotësimin e këtij kriteri.</u>
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më	Bazuar në shkresën e kodifikimit të programit të studimit, GJV konstaton që kodi 52PP0612S i korespondon programit të studimit Teknik i Lartë me profil Sisteme Kompjuterike, ndërkohë që kodifikimi duhet të kryhet për programin e Studimit me Karakter Profesional Teknik i Lartë me profile Sisteme Kompjuterike, Teknologji Informacioni dhe




te kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Komunikimi, Grafik, Web dhe Multimedia Dizajn. Konkretisht, 2 (dy) nga profilet e programit nuk pasqyrohen në evidencën e kodifikimit. <u>GVJ rekomandon</u> që kodifikimi i programit të studimit profesional me profile të kryhet në nivel programi studimi sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane (VKM. 310, datë 11.05.2022). Evidencë Dok 39 Shkresa e kodifikimit të programit “Teknik i Lartë.pdf			
Konkluzione	Bazuar në analizën e kriterëve 1-7 të standardit II.1, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se struktura e programit të studimit është organizuar në lëndë të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi, dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). <u>GVJ rekomandon:</u> - institucioni të bëjë më shumë kujdes në klasifikimin e lëndëve sipas kategorive A, B, C, D duke patur parasysh jo vetëm plotësimin e kësajve ligjore të VKM 41, por edhe tipologjinë dhe fushën specifike të programit të studimit. integrimi në Planit mësimor i tipologjisë (A, B, C, D, E) për secilin modul - rregullorja e programit të studimit duhet azhurnuar sipas riorganizimit të programit profesional të studimit me profile: - o Sisteme kompjuterike - o Teknologji informacioni dhe komunikimi - o Grafik, web dhe multimedia dizajn - kodifikimi i programit të studimit profesional me profile të kryhet në nivel programi studimi sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane (VKM. 310, datë 11.05.2022).			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
		X		

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.



Kriteret	Vlerësimi																																																														
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar, nga evidencat përkatëse që e shoqërojnë, por dhe nga takimet me dekanin, me përgjegjësin e departamentit dhe me stafin që mbulon programin, rezulton se DSLT është njësi bazë e KSLP. Ai e zhvillon veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në përmbushje të standardeve të cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim shkencor. KSLP ka në përbërje të tij: - Departamenti i Studimeve të Larta Administrative - Departamenti i Studimeve të Larta Teknike (DSLTP) Referuar të dhënave tabelore për personelin akademik rezulton se KSLP si njësi kryesore për programin e studimit për vitin akademik 2023-2024 ka gjithsej 25 pedagogë, nga të cilët 11 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 14 pedagogë me kontratë (PAK), me kualifikimin e mëposhtëm: <table><tr><th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th><th colspan="2">Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale</th><th>Raporti</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE / PAK</th></tr><tr><td>Prof. Dr.</td><td>0</td><td>0</td><td>0 / 0</td></tr><tr><td>Prof. as. Dr.</td><td>2</td><td>2</td><td>2 / 2</td></tr><tr><td>Dr/PhD</td><td>3</td><td>0</td><td>3 / 0</td></tr><tr><td>Dr. proc.</td><td>0</td><td>1</td><td>0 / 1</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>6</td><td>11</td><td>6 / 11</td></tr><tr><td>Total</td><td>11</td><td>14</td><td>11 / 14</td></tr></table> Ndërsa për vitin akademik 2024-2025 ka gjithsej 28 pedagogë, nga të cilët 13 janë pedagogë efektiv (PAE) dhe 15 pedagogë me kontratë (PAK), me kualifikimin e mëposhtëm: <table><tr><th rowspan="2">Kualifikimi i stafit</th><th colspan="2">Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale</th><th>Raporti</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE / PAK</th></tr><tr><td>Prof. Dr.</td><td>0</td><td>0</td><td>0 / 0</td></tr><tr><td>Prof. as. Dr.</td><td>3</td><td>0</td><td>3 / 0</td></tr><tr><td>Dr/PhD</td><td>4</td><td>0</td><td>4 / 0</td></tr><tr><td>Dr. proc.</td><td>0</td><td>2</td><td>0 / 2</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>6</td><td>13</td><td>6 / 11</td></tr><tr><td>Total</td><td>13</td><td>15</td><td>13 / 15</td></tr></table> Njësia bazë DSLT, që ofron programin e studimit përbëhet aktualisht nga 7 anëtarë të personelit akademik efektiv (PAE), nga të cilët (2) me titull Prof. As. Dr., (1) me Dr. si edhe (4) me Msc. Gjithashtu, në departament janë të përfshirë edhe 9 antarë të	Kualifikimi i stafit	Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale		Raporti	PAE	PAK	PAE / PAK	Prof. Dr.	0	0	0 / 0	Prof. as. Dr.	2	2	2 / 2	Dr/PhD	3	0	3 / 0	Dr. proc.	0	1	0 / 1	Msc.	6	11	6 / 11	Total	11	14	11 / 14	Kualifikimi i stafit	Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale		Raporti	PAE	PAK	PAE / PAK	Prof. Dr.	0	0	0 / 0	Prof. as. Dr.	3	0	3 / 0	Dr/PhD	4	0	4 / 0	Dr. proc.	0	2	0 / 2	Msc.	6	13	6 / 11	Total	13	15	13 / 15
Kualifikimi i stafit	Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale		Raporti																																																												
	PAE	PAK	PAE / PAK																																																												
Prof. Dr.	0	0	0 / 0																																																												
Prof. as. Dr.	2	2	2 / 2																																																												
Dr/PhD	3	0	3 / 0																																																												
Dr. proc.	0	1	0 / 1																																																												
Msc.	6	11	6 / 11																																																												
Total	11	14	11 / 14																																																												
Kualifikimi i stafit	Kolegji i Studimeve të Larta Profesionale		Raporti																																																												
	PAE	PAK	PAE / PAK																																																												
Prof. Dr.	0	0	0 / 0																																																												
Prof. as. Dr.	3	0	3 / 0																																																												
Dr/PhD	4	0	4 / 0																																																												
Dr. proc.	0	2	0 / 2																																																												
Msc.	6	13	6 / 11																																																												
Total	13	15	13 / 15																																																												

personelit akademik me kontratë (PAK). Tabela më poshtë pasqyron personelin akademik të njësisë bazë (DSLTL) për vitet akademike 2023-2024 dhe 2024-2025.

Tituj/ grada	2023-2024		2024-2025	
	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	-	-	-	-
Prof. as. Dr.	1	2	2	-
Dr./PhD.	1	-	1	-
Dr. proc.	-	1	-	1
Msc.	5	9	4	8
Total	7	12	7	9

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe nga vizita në institucion, GVJ konstaton se DSLTL përmbush kriteret për të qenë departament.

Në Vendimin e MASR nr.418, datë 10.5.2017, "Për standardet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre", thuhet se: "*Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për çdo program studimi*" (pika 2.b.ii). GVJ vlerëson se raporti PAE/PAK në lidhje me ngarkesën mësimore të mbuluar në programin, për vitet 2023-2024 dhe 2024-2025 është si më poshtë:

Viti Akademik	Raporti PAE / PAK	Raporti PAE / PAK në orë	Raporti PAE / PAK në %	Profili
2023-2024	5 / 3	400 / 200	67% / 33%	SK / TIK / GWMD
2024-2025	11 / 5	950 / 250	79.16% / 20.84%	SK / TIK
2024-2025	11 / 4	1000 / 200	83.3% / 16.7%	GWMD

GVJ konstaton se në vitin akademik 2023-2024 raporti PAE / PAK është 67% / 33%, sepse 1 staf me Msc është e angazhuar si PAK dhe jo si PAE. Gjithashtu, ky raport ndikohet negativisht edhe nga fakti se 1 staf me Msc, në këtë periudhë, nuk është e angazhuar si staf akademik PAE. (340 / 260; **56.6% / 43.3%**) (Evidencë 13) GVJ rekomandon që në vazhdim KUB t'i kushtojë vëmendje përmbushjes së Vendimit të MASR nr.418, datë 10.5.2017, pika 2.b.ii, për mbulimin e ngarkesës mësimore minimalisht 70% nga staf PAE..

	Evidencë Dok 17 Statuti i KUB.pdf Evidencë Dok 14. Rregullore e KSLP.pdf Evidencë shtesë 2.Tabela permbledhese RVB TL_LR.pdf Evidencë Dok 60. Lista e stafit dhe Ngarkesa Vjetore e Stafit Akademik të Programit “ Teknik i Lartë”.pdf Evidencë Dok 13 Lista e plotë e personelit të KUB 2023-2024 dhe 2024-2025.pdf
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton se njësia kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, në plotësim të detyrimeve të përcaktuara ligjore, ka të angazhuar personel ndihmës akademik/administrativ në mbështetje të realizimit të procesit mësimorë (Tabela 2 / 2024-2025). Evidencë Dok 60. Lista e stafit dhe Ngarkesa Vjetore e Stafit Akademik të Programit “ Teknik i Lartë”.pdf
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe takimin me studentë, GVJ konstaton se nuk ka një evidencë ku reflekton se njësia bazë (DSLIT), përgjegjëse për programin e studimit, të ketë caktuar koordinatorin e programit të studimit. Një mungesë e tillë u reflektua edhe në takimin me studentë. <u>GVJ sugjeron që KUB të caktojë një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili do të jetë përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit në përputhje me objektivat e tij.</u>
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-3 të standardit II.2, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se:</i> - <i>Njësia kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit ka të angazhuar personel ndihmës</i>

	<i>akademik/administrativ në mbështetje të realizimit të procesit mësimorë.</i> - <i>DSLIT përmbush kriteret për të qenë departament.</i> - <i>GVJ rekomandon që në vazhdim KUB t'i kushtojë vëmendje përmbushjes së Vendimit të MASR nr.418, datë 10.5.2017, pika 2.b.ii, për mbulimin e ngarkesës mësimore minimalisht 70% nga staf PAE..</i> - <i>GVJ sugjeron që KUB të caktojë një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili do të jetë përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	GVJ konstaton se DSLT, si njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, disponon informacionin për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Ky informacion publikohet pjesërisht edhe në faqen e KUB (https://kub.edu.al/kolegji-i-studimeve-te-larta-profesionale/). DSLT, disponon informacionet dhe ka vënë në dispozicion dokumentacionin për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit si: kurrikulën, planin mësimor, syllabuset e lëndëve, stafin akademik të programit etj. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, vizita në institucion dhe dokumentacioni shtesë i kërkuar, GVJ konstaton se rregulloret e KSLP, DSLT dhe e programit nuk janë të azhuruara sipas tre profileve: “Sisteme Kompjuterike”, “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” dhe “Grafik, Web dhe Multimedia Dizajn”. Në secilën prej rregulloreve rezultojnë profilet e programit Teknik i Lartë para riorganizimit (UMASR, nr. 343, dtatë 06.07.2023): “Sisteme Kompjuterike”, “Sisteme Elektrike” dhe “Sisteme Motorike”, duke theksuar se profili “Sisteme Kompjuterike”

	ka një kurrikul të ndryshme nga profili i ri “Sisteme Kompjuterike”. <i>GVJ rekomandon azhornimin/hartimin e rregulloreve të KSLP, DSLT dhe të programit sipas profileve të reja të programit profesional të riorganizuar.</i> Evidencë Dok 14. Rregullore e KSLP.pdf Evidencë Dok 15. Rregullore e DSLT.pdf Evidencë Dok 10 Rregullore e programit të studimit “Teknik i Lartë”.pdf Evidencë Dok 41 Dosja fizike e departamentit..pdf Evidencë Dok 45 Struktura e vitit akademik për programin Teknik I Lartë, plani dhe orari mësimor.pdf Evidencë shtesë TL GWMD SYLLABUS 24-25.pdf Evidencë shtesë TL SIST KOMPJ 24-25.pdf Evidencë shtesë TL TIK 2024-2025.pdf https://kub.edu.al/kolegji-i-studimeve-te-larta-profesionale/
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve në kredite, orët në auditor/jashtë auditorit.	Nga shqyrtimi i planit mësimor dhe syllabuseve të programit të studimit, GVJ konstaton se ky program studimi përmban 21 lëndë semestrale (nga këto 4 lëndë me zgjedhje), Praktikë Profesionale I & II dhe Provim Formimi. Në vitin e parë zhvillohen 12 lëndë semestrale (nga këto 2 lëndë me zgjedhje dhe Praktikë Profesionale I), ndërsa në vitin e dytë 11 lëndë semestrale (nga këto 2 lëndë me zgjedhje dhe Praktikë Profesionale II) dhe Provim Formimi. Programi i studimit përmban në planin mësimor informacionin e nevojshëm për: – grupin e lëndëve që studenti kryen çdo semestër dhe çdo vit akademik; – numrin total të krediteve që fiton studenti si dhe numrin e krediteve për secilën lëndë, si dhe orët në total për çdo lëndë në auditor / punë individuale. – ngarkesën mësimore të secilës lëndë, sipas veprimtarive mësimore: leksion, seminar, laborator etj. Bazuar në takimin në institucion me Zyrën e Kurrikulave, KUB ka miratuar me vendim senati korespondencën 1 kredit ECTS, 10 orë mësimore në auditor dhe 15 orë mësimore punë individuale. Kjo është e pasqyruar edhe në planin mësimor. GVJ mendon që kjo skemë nuk i përgjigjet njëloj interesave të të gjitha lëndëve, psh për lëndët e praktikës profesionale raporti orë në auditor/orë punë individuale duhet të jetë i tillë që të ofrojë më shumë orë punë fizike praktike dhe më pak

	orë punë individuale. Ndërkohë që për Provimin e formimit pjesa më e madhe e ngarkesës i takon punës individuale të studentit. <i>GVJ rekomandon të rishikohet skema e korespondencës orë mësimore për kredit ECTS nga të gjithë instancat përgjegjëse të programit të studimit dhe Zyrën e Kurrikulës.</i> <i>GVJ rekomandon që në planin mësimor krahas kolonës për "Leksione", "Seminare" dhe "Laboratore", të shtohet një kolonë për Praktikën Profesionale në mënyrë që kolona "Ngarkesa e lëndëve gjithsej në orë mësimore" të jetë e barabartë me totalin e kolonave "Leksione", "Seminare", "Laboratore" dhe "Praktikë Profesionale", për secilin profil (Evidencë 45).</i> Evidencë Dok 45 Struktura e vitit akademik për programin Teknik I Lartë, plani dhe orari mësimor.pdf Evidencë shtesë TL GWMD SYLLABUS 24-25.pdf Evidencë shtesë TL SIST KOMPJ 24-25.pdf Evidencë shtesë TL TIK 2024-2025.pdf
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët, që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Nga shqyrtimi i Statutit të KUB (Neni 61), Rregullores së KSLP (Neni 26, pika 2), Rregullores së DSLT (Neni 22, pika 2), GVJ konstaton se në mënyrë të përmblëdhur thuhet se: <i>"Kriteri bazë i pranimit në programet e larta profesionale është mbarimi me sukses i ciklit të arsimit të mesëm".</i> Nga shqyrtimi i Statutit të KUB (Neni 67), Rregullores së KSLP (Neni 32), Rregullores së DSLT (Neni 28), Rregullores së Ekuivalentimit dhe Rregullores së transferimit të programeve rezulton se përshkruhet qartë procedura e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Evidencë Dok 17 Statuti i KUB.pdf Evidencë Dok 14. Rregullore e KSLP.pdf Evidencë Dok 15. Rregullore e DSLT.pdf Evidencë Dok 25. Rregullore e Ekuivalentimit.pdf Evidencë Dok 42. Rregullore e transferimit të programeve.pdf
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të	Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se në rregulloren e programit të studimit, si dhe në syllabuset e lëndëve, paraqitet informacion i hollësishëm mbi detyrimin e frekuentimit / ndjekjes së programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve, etj. Syllabuset e lëndëve janë hartuar sipas formatit të miratuar sipas VKM Nr. 185, datë 25.3.2021, "Për disa ndryshime dhe shtresa në VKM nr. 41, datë 24.1.2018, "Për



gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.

elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”, të ndryshuar dhe informojnë në lidhje me detyrimin për frekuentimin/ ndjekjen e programit nga studenti, mënyrën e vlerësimit të dijeve, literaturën, pedagogun e lëndës etj.

GVJ konstaton se në një pjesë të konsiderueshme të syllabuseve:

- literatura e rekomanduar nuk është përditësuar dhe nuk ka një standard të unifikuar për stilin e referencave.
- ka mospërputhje mes ngarkesës mësimore dhe/ose veprimtarive mësimore të paraqitura në syllabus me atë që është miratuar në planin mësimor. Psh:

Lënda SK	Plan			Syllabus		
	Lex	Ush	Lab	Lex	Sem	Lab/Prak
Sistemi Linux	25	13	10	25	5	20
Elektronike	24	12	12	25	5	20

- ka mospërputhje mes masës së frekuentimit të detyrueshëm që reflektohet në syllabuse me masën e frekuentimit që reflektohet në Rregulloren e KUB (Neni 89, pika 1), Rregulloren e KSLP (Neni 42, pika 1), ku frekuentimi i leksioneve dhe seminareve është i detyrueshëm në masën 50%. (mund të përmendim syllabuse të profilit SK: “Matematikë teknike”, “Fizikë”, “Elektronikë”, “Protokolle komunikimi”-mungon, “Sistem Linux”, “Sistemet Wireless” etj.)
- mungon masa e frekuentimit të laboratoreve në syllabuse dhe në rregulloret e KUB, KSLP etj.

GVJ rekomandon të përditësohet dhe citohet/referohet sipas një stili literatura e rekomanduar, të rakordohet mospërputhja e ngarkesës dhe/ose veprimtarive mësimore që reflektohen në syllabus-e me atë që është miratuar në planin mësimor, të rregullohet masa e frekuentimit të detyrueshëm të leksioneve dhe seminareve bazuar në rregulloret përkatëse dhe të parashikohet në to masa e frekuentimit të laboratoreve.

Evidencë Dok 18 Rregullore e KUB_11zon.pdf

Evidencë Dok 14. Rregullore e KSLP.pdf

Evidencë shtesë TL GWMD SYLLABUS 24-25.pdf

Evidencë shtesë TL SIST KOMPJ 24-25.pdf

	Evidencë shtesë TL TIK 2024-2025.pdf
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm. Në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në njësinë bazë.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton se përditësimi i programeve të lëndëve që janë pjesë e programit të studimit propozohet çdo fillim semestri nga personeli akademik i lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i njësisë bazë që e ofron atë lëndë. Kjo reflektohet edhe nga riorganizimi që i është bërë këtij programi studimi duke përshtatur profilet e teknikut të lartë me kërkesat e tregut të punës.
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-5 të standardit II.3, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se:</i> - <i>Njësia bazë përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, disponon informacionin për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</i> - <i>Plani mësimor përfshin informacionin e nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/punë individuale.</i> - <i>KUB ofron të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</i> - <i>Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm.</i> <u>GVJ rekomandon:</u> - <i>të rishikohet skema e korespondencës orë mësimore për kredit ECTS nga të gjithë instancat përgjegjëse të programit të studimit dhe Zyrën e Kurrikulës.</i> - <i>të azhurnohet përmbajtja e rregulloreve të KSLP, DSLT dhe të programit sipas profileve të reja të programit profesional të riorganizuar.</i> - <i>në planin mësimor krahas kolonës për “Leksione”, “Seminare” dhe “Laboratore”, të shtohet një kolonë për Praktikën Profesionale.</i> - <i>të përditësohet dhe citohet/referohet sipas të njejtit stil literatura e rekomanduar, të rakordohet mospërputhja e ngarkesës dhe/ose veprimtarive mësimore që reflektohen në syllabus-e me atë që është miratuar në planin mësimor, të rregullohet masa e frekuentimit të detyrueshëm të leksioneve dhe seminareve bazuar në rregulloret përkatëse dhe të</i>

	parashikohet në to masa e frekuentimit të laboratoreve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi												
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive profesionale drejt punësimit të studentëve.	GVJ konstaton se shpërndarja e lëndëve dhe përmbajtja e veprimtarive të paraqitura në planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve mundësojnë përgatitjen e studentëve me aftësitë dhe dijet e nevojshme teorike dhe praktike për punësim në tregun e punës vendas dhe jashtë. Në kurrikulën e programit të studimit është parashikuar zhvillimi i praktikës profesionale si lëndë apo veprimtari formuese gjatë të dy viteve akademike. Bazuar në analizën e tregut të punës programi i studimit “Teknik i Lartë” me profilet përkatëse bën pjesë në fushën <i>Sherbime</i> e cila rezulton të ketë një punësim të studentëve në masën 90%. Institucioni nuk ka të dhëna për punësimin e studentëve duke qenë se periudha e akreditimit është para diplomimit të brezit të parë. Evidencë Dok.36 Planet mësimore për vitin akademik , 2023-2024 dhe 2024-2025.pdf Evidencë shtesë TL GWMD SYLLABUS 24-25.pdf Evidencë shtesë TL SIST KOMPJ 24-25.pdf Evidencë shtesë TL TIK 2024-2025.pdf Evidencë Dok.12, Studim i Tregut të Punës për programin e studimit “Teknik i Lartë”.pdf												
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit	Mbështetur në shqyrtimin e planit mësimor të programit TLSKTIKGWMD u evidentua shpërndarja e ngarkesës mësimore në 4 semestrat e realizimit të programit, e cila është e balancuar për çdo semestër. Ngarkesa mësimore javore në auditor është: <table><tr><td>Semestri I</td><td>30 kredite</td><td>15 javë</td><td>20 orë/javë</td><td></td><td></td></tr><tr><td>Semestri II</td><td>30</td><td>12 javë</td><td>19</td><td>3</td><td>15</td></tr></table>	Semestri I	30 kredite	15 javë	20 orë/javë			Semestri II	30	12 javë	19	3	15
Semestri I	30 kredite	15 javë	20 orë/javë										
Semestri II	30	12 javë	19	3	15								

dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.		kredite		orë/javë	javë	orë/javë
	Semestri III	30 kredite	15 javë	20 orë/javë		
	Semestri IV	30 kredite	12 javë	15 orë/javë	3 javë	15 orë/javë
Bazuar në planin mësimor dhe strukturën e vitit akademik, GVJ konstaton se në semestrin e II-të dhe të IV-t për Praktikën Profesionale janë të planifikuara 3 javë. Shpërndarja e lëndëve në semestra mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit. Ngarkesa totale vjetore e orëve në auditor dhe orë pune të pavarur është 1500 orë për secilin prej viteve dhe raporti orë në auditor/punë e pavarur e studentit plotëson kornizën ligjore në fuqi. Duke qenë se detyrimet përmbyllëse për këtë program studimi realizohen me provim, <u>GVJ rekomandon që Provim Formimi (60 orë në auditor) të kalojë orë e individuale e studentit, duke qenë se nuk cënon gjithashtu edhe raportin PAE/PAK për ngarkesën mësimore të shpërndarë dhe nuk ka një syllabus.</u> Evidencë Dok 45 Struktura e vitit akademik për programin Teknik I Lartë, plani dhe orari mësimor.pdf						
Kriteri 3. Programi i studimit ka një raport të balancuar midis moduleve/aktiviteteve të formimit teorik përkundrejt atyre praktike (50:50). Rreth 25% e programit i dedikohet aftësimit në praktikë/punë konkrete në profesion. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se shpërndarja e ngarkesës mësimore në të 4 semestrat e realizimit të programit është e balancuar. Referuar strukturës së planit mësimor të programit evidentohet se: - Gjatë vitit të parë zhvillohen lëndë me natyrë karakterizuese (4 lëndë) nëpërmjet të cilave sigurohet aftësi, kompetenca dhe formim i thelluar profesional. Gjithashtu në këtë vit trajtohen edhe lëndët e formimit bazë (3 lëndë), lëndë ndërdisiplinore (2 lëndë) dhe lëndë plotësuese (3 lëndë). - Ndërkohë që në vitin e dytë zhvillohen lëndë me natyrë karakterizuese (8 lëndë), duke zënë pjesën më të madhe të programit, lëndë ndërdisiplinore (2 lëndë) dhe lëndë plotësuese (1 lëndë). GVJ konstaton se struktura, lëndët dhe raporti teori-praktikë (514 orë/587 orë) janë në përputhje me profilin e programit të studimit. (Tabela 13) Evidencë Dok 45 Struktura e vitit akademik për programin Teknik I Lartë, plani dhe orari mësimor.pdf Evidencë shtesë 2.Tabela permbledhese RVB TL_ LR.pdf					
Kriteri 4. Ndarja sipas	Në këtë program studimi, gjatë 2 viteve akademike zhvillohen					

veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	1140 orë mësimore në auditor përkatësisht: - 514 orë leksion - 291 orë ushtrime - 196 orë laboratore - 39 orë forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe detyra kursi - 100 orë praktikë profesionale dhe - 1860 orë mësimore punë e pavarur Gjatë takimeve me personelin akademik dhe me studentët e programit të studimit, si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit evidentohet se raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve dhe mobilitet gjatë studimit, si dhe aftësimin e tyre për tregun e punës. <i>GVJ rekomandon që DSLT të punojë për rritjen e mobiliteteve në kuadër të bashkëpunimeve në projekte Erasmus+ që lidhen ngushtë me fushën e këtij programi studimi. (Tabela 20)</i> Evidencë Dok 45 Struktura e vitit akademik për programin Teknik I Lartë, plani dhe orari mësimor.pdf Evidencë shtesë 2.Tabela permbledhese RVB TL_ LR.pdf
Kriteri 5. Syllabusët (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme, për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në institucion, GVJ konstaton se përditësimi i programeve të lëndëve që janë pjesë e programit të studimit mund të propozohet nga personeli akademik i lëndës, departamenti, Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK) apo rekomandimet e NJSBC si përgjigje ndaj kërkesave të tregut të punës. Pasi shqyrtohet në Departament dërgohet për miratim në mbledhjen e Dekanatit dhe më pas në Senatin Akademik të KUB vetëm përpara fillimit të vitit të ri akademik. (Rregullore e DSLT, Neni 6). <i>GVJ nuk eidentoi ndryshime në dokumentacion në përputhje me LAL 80/2015, Neni 35, Pika 4.</i> Evidencë Dok 15. Rregullore e DSLT.pdf Evidencë Dok 24 Rregullore e ZSKK (Zyra për Këshillim të Studentit dhe Karrierën).pdf Evidencë Dok. 31, Raporti i IQE_11zon.pdf
Kriteri 6. Bashkëpunimi me punëdhënësit, internship-i/përvoja praktike, tutorazhi, e vlerësimi i tyre në profesion është e	Përmbajtja e programit të studimit TLSKTIKGWMD, bazohet në: - VKM-në nr.41, datë 24.1.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, i ndryshuar, - në Rregulloren e KUB, - planin mësimor, - në syllabusët e Programit të Studimit


mjaftueshme, e përshtatshme dhe garanton formimin praktik në përputhje me kërkesat e profesionit.	ku parashikohen aftësitë dhe kompetencat që do të përfitojnë studentët pas përfundimit me sukses të programit të studimit. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe nga takimi me studentë, GVJ evidentoi se përvoja praktike që studentët kishin ishte në përputhje me kërkesat e profesionit dhe vinte si rezultat i praktikës profesionale të ofruar nga marrëveshjet e bashkëpunimit që KUB ka me institucione/servise/qendra të ndryshme, siç mund të përmendim Copier Computer Center, afër ambienteve të institucionit. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, GVJ konstaton se Rregullorja e zhvillimit të Praktikës Profesionale në KSLP, Neni 4, ka mospërputhje të pikëve kredite dhe kohëzgjatjes në javë me ato të miratuara në planin mësimor dhe syllabuse si mëposhtë: <table><tr><th></th><th>Kredite</th><th>Kohëzgjatja</th></tr><tr><td>Plan/syllabus</td><td>10 ECTS</td><td>3 javë</td></tr><tr><td>Rregullore e praktikës</td><td>8 ECTS</td><td>5 javë</td></tr></table> <i>GVJ rekomandon hartimin e një pakete për Praktikën Profesionale për programin e studimit TLSKTIKGWMD në harmoni në rregulloret institucionale të IAL-së.</i> Evidencë Dok 18 Rregullore e KUB_11zon.pdf Evidencë Dok.20 Lista e kompanive, institucioneve dhe subjekteve me të cilët DSLT ka marrëveshje.pdf Evidencë shtesë TL GWMD SYLLABUS 24-25.pdf Evidencë shtesë TL SIST KOMPJ 24-25.pdf Evidencë shtesë TL TIK 2024-2025.pdf Evidencë Dok 21 Rregullore e Praktikës Profesionale.pdf Evidencë Dok 62. Modele vlerësimi të raportit të praktikës profesionale.pdf		Kredite	Kohëzgjatja	Plan/syllabus	10 ECTS	3 javë	Rregullore e praktikës	8 ECTS	5 javë
	Kredite	Kohëzgjatja								
Plan/syllabus	10 ECTS	3 javë								
Rregullore e praktikës	8 ECTS	5 javë								
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, në përputhje me nivelin 5	Përmbajtja e programit të studimit jep mundësi të mëtjshme punësimi të studentëve në përputhje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës. Me këtë kurrikul përgatiten Teknikë të Lartë në profilet përkatëse, të cilët fitojnë kompetencat e duhura për të qenë pjesë dhe për t'u punësuar në servise, kompani apo institucione publike/private që kanë fokus mirëmbajtjen, riparimin, implementimin e sistemeve apo rrjeteve kompjuterike, krijimin dhe mirëmbajtjen e faqeve të internetit etj. Evidencë Dok.36 Planet mësimore për vitin akademik , 2023-2024 dhe 2024-2025.pdf Evidencë Dok 29 Raporti Vjetor i KUB për vitin akademik 2023-									

të KSHK.	2024 dhe Raporti semestrit parë 2024-2025.pdf Evidencë Dok 81 Raport i studimit të tregut nga ZSKK.pdf			
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-7 të standardit II.4, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se:</i> - <i>Shpërndarja e lëndëve dhe përmbajtja e veprimtarive të paraqitura në planin mësimor dhe syllabuset e lëndëve mundësojnë përgatitjen e studentëve me aftësitë dhe dijet e nevojshme teorike dhe praktike për punësim në tregun e punës vendas dhe jashtë.</i> - <i>Shpërndarja e lëndëve në semestra mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit.</i> - <i>Struktura, lëndët dhe raporti teori-praktikë (514orë/587 orë) janë në përputhje me profilin e programit të studimit.</i> - <i>GVJ rekomandon që Provim Formimi (60 orë në auditor) të kalojë orë individuale e studentit, duke qenë se nuk cënon gjithashtu edhe raportin PAE/PAK për ngarkesën mësimore të shpërndarë dhe nuk ka një syllabus.</i> - <i>GVJ rekomandon që DSLT të punojë për rritjen e mobiliteteve në kuadër të bashkëpunimeve në projekte Erasmus+ që lidhen ngushtë me fushën e këtij programi studimi.</i> - <i>GVJ rekomandon hartimin e një pakete për Praktikën Profesionale për programin e studimit TLSKTIKGWMD në harmoni me rregulloret institucionale të KUB.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tij.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecursisë së programit të	GVJ, nga vizita në institucion, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion (RVB) dhe nga dokumentacioni shtesë i kërkuar, konstaton se për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit në raport të drejtë me kërkesat e tregut të punës, IAL konsultohet dhe bashkëpunon ngushtë me pedagogë të Inxhinierisë dhe shkencave kompjuterike, përfaqësues të




studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	serviseve apo kompanive të ndryshme ku zhvillohet praktika si edhe me raportet e NJSBC që kanë lidhje me propozimet e studentëve. GVB shprehet se në funksion të këtij përmirësimi është ngritur një Bord Këshillimi për Karrierën pranë KUB, megjithatë <i>mungon evidenca 47, për krijimin dhe funksionimin e një strukture të tillë, që referohet në RVB.</i> Evidencë Dok 81 Raport i studimit të tregut nga ZSKK.pdf
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Nga vizita në institucion si dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion (RVB), GVJ konstaton se një rol të rëndësishëm në përmirësimin e programit të studimit e luajnë studentët. Nga takimi me studentë, GVJ konstaton se ato janë pjesë e takimeve të vazhdueshme që realizohen në departament për shprehjen dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme që ato mund të kenë. Megjithatë, GVJ, në mungesë të një <i>evidence për krijimin dhe funksionimin e Bordit të Këshillimit të Karrierës (alumni, evidencë 47), nuk është në gjendje të vlerësojë plotësisht kriterin.</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me kompani, rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë dhe institucione publike e private.	DSLIT në komunikim të vazhdueshëm me biznese apo institucione me interes, realizon konsultime për përmbushjen e nevojave të tregut të punës nëpërmjet përditësimeve apo përshtatjeve që mund t'i bëhen programit të studimit për të arritur objektivat dhe rezultatet e të nxënit. Përmendim këtu CCC. Evidencë Dok 48 Protokolli i mbledhjeve të departamentit të DSLIT.pdf Evidencë Dok.20 Lista e kompanive, institucioneve dhe subjekteve me të cilët DSLIT ka marrëveshje.pdf
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-3 të standardit II.5, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se:</i> - GVJ konstaton se një rol të rëndësishëm në përmirësimin e programit të studimit luajnë studentët. - GVJ konstaton se <u>mungon</u> evidencë për krijimin dhe funksionimin e Bordit të Këshillimit të Karrierës. - GVJ konstaton se studentët janë pjesë e takimeve të vazhdueshme që realizohen në departament për shprehjen dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme që ato mund të kenë.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1


Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në KUB, GVJ konstaton se personeli akademik i programit të studimit TLSKTIKGWMD zhvillon forma të mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive përmes leksioneve, seminareve, punëve laboratorike, detyrave të kursit, praktikave profesionale të miratuara nga IAL bazuar në rregulloren e KUB. Personeli akademik është mbështetur nga KUB në rritjen akademike dhe profesionale dhe është udhëzuar mbi metodat e reja të mësimdhënies inovative. Evidencë Dok 18 Rregullore e KUB_11zon.pdf Evidencë Dok 15. Rregullore e DSLT.pdf Evidencë Dok 14. Rregullore e KSLP.pdf Evidencë shtesë TL GWMD SYLLABUS 24-25.pdf Evidencë shtesë TL SIST KOMPJ 24-25.pdf Evidencë shtesë TL TIK 2024-2025.pdf
Kriteri 2. Personeli akademik, personeli ndihmës akademik respektojnë dhe u përgjigjen larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative	Nga bisedat që realizoi GVJ me anëtarët e personelit akademik efektiv, si edhe me studentët e programit të studimit, rezultoi se personeli akademik u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. Gjithashtu u konstatua se gjatë zhvillimit të mësimdhënies përdoren edhe mjete audio vizuale jo vetëm

të mësimdhënies e mësimnxënies.	nga lektorët, por edhe nga studentët gjatë prezantimit të detyrave të kursit, punimeve në grup, apo edhe atyre individuale. KUB ka infrastrukturën e nevojshme për të ofruar forma dhe metoda të larmishme të mësimdhënies dhe mësimnxënies ndërthurur dhe me aksesin e librave në bibliotekën online. Evidencë Dok 58. Urdhër Rektori Nr 241 , date 05.12.2024,.pdf Evidencë Dok 63 Relacion mbi Infrastrukturën dhe kapacitetet pritëse..pdf Evidencë Dok 64 Adresa dhe kontrata e Bibliotekës elektronike “J Store”. jstor.org ku kanë akses të gjithë.pdf Evidencë 2.Tabela permbledhese RVB TL_ LR.pdf - Tabela 16, 17
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik dhe ndihmës akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe pedagogjike, në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, në përgjigje dhe të diversitetit dhe nevojave të studentëve.	Institucioni e mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. KUB zbaton një politikë të mirëpërcaktuar për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të personelit akademik. Format e mbështetjes janë: - Mobilitete ndërkombëtare; - Projekte të Komunitetit European; - Udhëzues i metodave inovative të mësimdhënies; - Leksione të hapura dhe trajnime; - Kualifikime dhe specializime jashtë institucionit. Evidencë Dok 58. Urdhër Rektori Nr 241 , date 05.12.2024,.pdf Evidencë 2.Tabela permbledhese RVB TL_ LR.pdf - Tabela 19, 20, 22 Evidencë Dok 33 Raporti i Punes Kerkimore Shkencore dhe Projekteve permbledhese per periudhen 20-24_11zon.pdf Evidencë Dok 29 Raporti Vjetor i KUB për vitin akademik 2023-2024 dhe Raporti semestrit parë 2024-2025.pdf
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxitin mendimin krijues dhe kritik	Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe vizita në KUB, GVJ konstaton se personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në TLSKTIKGWMD, ka formimin e duhur dhe në përputhje me fushën e programit të studimit. Metodatat e mësimdhënies të përdorura nga stafi akademik përshkruhen edhe në seksionin përkatës në syllabusin e lëndës. Gjatë takimeve të zhvilluara në institucion u konkludua mbështetje në marrëdhëniet e krijuara me respekt të ndërsjellët mes dekanit, përgjegjësit të departamentit, stafit akademik, stafit administrativ dhe studentëve.



te student. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Evidencë shtesë CV e stafit Evidencë shtesë TL GWMD SYLLABUS 24-25.pdf Evidencë shtesë TL SIST KOMPJ 24-25.pdf Evidencë shtesë TL TIK 2024-2025.pdf
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	Rezultatet e anketimeve dhe vlerësimeve periodike të anketës vlerësuese të studentit për stafin akademik, ku përfshihen dhe format dhe metodat e mësimdhënies, i komunikohen çdo pedagogu. KUB ka zhvilluar mekanizma për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë, që janë rregulluar me rregulloret përkatëse, zyrat për monitorimin e brendshëm të cilësisë dhe raportimi përkatës pranë njësive kryesore dhe bazë. Në kuadër të përmirësimit të programit, IAL nxit dhe përfshin në diskutime dhe studentët nëpërmjet: - Anketimit për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit nga studentët e regjistruar, - Përshirjen në strukturat e monitorimit dhe sigurimit të cilësisë, - Vëzhgimi i drejtpërdrejtë i pedagogut gjatë procesit mësimor. Evidencë Dok 59 Pyetësor i studentëve dhe pedagogëve nga NJSBC.pdf Evidencë Dok 51 Raport i NJSBC për vitin akademik 2023-2024.pdf Evidencë Dok.28. Vendimi i SA "Për ngritje strukturash mbështetëse dhe emërimet përkatëse në KUB".pdf Evidencë Dok 11 Planet strategjike të zhvillimit të IAL Kolegji Universitar i Biznesit.pdf Evidencë Dok 5 Propozim për GVB me nr.114, datë 26.01.2025.pdf Evidencë Dok 78 Vendimi i Senatit për pjesëmarrjen si anëtar i Senatit i përfaqësuesit të studenteve.pdf
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të	Në nivel institucioni puna për vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës-akademik drejtohet nga NJSBC. Kjo njësi ka rregulloren e saj, ku përcaktohet edhe mënyra e organizimit dhe detyrat që kanë njësitë kryesore dhe bazë. GVJ konstatoi se garantimi i përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve mundësohet nëpërmjet pyetësorit të vlerësimit të cilësisë së mësimdhënies në programin e studimit, i cili




përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik dhe ndihmës akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	plotësohet nga studentët në mënyrë periodike. Ky pyetësor është anonim dhe gjithë procesi drejtohet dhe monitorohet nga NJSBC. Rezultatet e pyetësorit, të paraqitura të përmbledhura në raport dhe që i komunikohen personelit akademik, shërbejnë si bazë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Kjo anketë mundëson gjithashtu rritjen e vetëdijes së personelit akademik dhe studentëve për cilësinë në mësimdhënie. Nga takimet në institucion, GVJ u informua se personeli akademik ka në fokusin e tij përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies. Në mënyrë të veçantë në këtë drejtim kanë kontribuar mobilitetet e personelit akademik në universitete jashtë vendit. Evidencë Dok 59 Pyetësor i studentëve dhe pedagogëve nga NJSBC.pdf Evidencë Dok 51 Raport i NJSBC për vitin akademik 2023-2024.pdf Evidencë Dok 11 Planet strategjike të zhvillimit të IAL Kolegji Universitar i Biznesit.pdf Evidencë Dok 26. Rregullore e NJSBC.pdf Evidencë Dok 29 Raporti Vjetor i KUB për vitin akademik 2023-2024 dhe Raporti semestrit parë 2024-2025.pdf Evidencë Dok 33 Raporti i Punes Kerkimore Shkencore dhe Projekteve përmbledhese për periudhën 20-24_11zon.pdf
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-6 të standardit III.1, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se:</i> - <i>Personeli akademik i programit të studimit TLSKTIKGWMD zhvillon format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive të miratuara nga IAL nëpërmjet rregulloreve specifike.</i> - <i>KUB angazhohet në mbështetjen e personelit akademik për përmirësimin e kompetencave të tyre didaktike. DSLT vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë dhe reflektuar mendimin e studentëve.</i> - <i>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në KUB organizon, drejton dhe monitoron përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies në nivel institucional.</i>
Shkalla e përmbushjes së	Nuk Përmbushet Përmbushet Përmbushet




standardit		kryesisht	plotësisht
			X

Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	GVJ konstaton se kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në rregulloren e institucionit, atë të programit të studimit dhe syllabus-et e lëndëve të cilat u bëhen të njohura studentëve javën e parë të çdo semestri akademik. Vlerësimi i kontrollit të dijes bëhet me notë, ku 5 është nota kaluese dhe 10 është vlerësimi më i lartë. Evidencë Dok 18 Rregullore e KUB_11zon.pdf Evidencë Dok 14. Rregullore e KSLP.pdf Evidencë Dok 15. Rregullore e DSLT.pdf Evidencë Dok 10 Rregullore e programit të studimit “Teknik i Lartë”.pdf Evidencë shtesë TL GWMD SYLLABUS 24-25.pdf Evidencë shtesë TL SIST KOMPJ 24-25.pdf Evidencë shtesë TL TIK 2024-2025.pdf
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga bisedat që realizoi grupi i punës së vlerësimit të jashtëm me anëtarët e personelit akademik efektiv, si edhe me studentët e programit të studimit, rezultoi se pedagogët në fillim të çdo lënde/moduli informojnë studentët për format e vlerësimit të njohurive dhe aftësive, për metodologjinë e testimit, për detyrimet lëndore së bashku me afatet për secilin detyrim që mbështesin vlerësimin formues dhe përmblendhës të studentëve.
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe	Konstatohet se, nga shqyrtimi i dokumentacionit, vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme. Komponentët e vlerësimit sipas peshës përkatëse në përqindje të pasqyruara në syllabus-et e lëndëve janë: - Pjesëmarrje – 10 pikë - Aktivizim/Punë praktike – 10 pikë




kompetencat e fituara si në teori ashtu edhe në aftësitë praktike.	- Testim ndërmjetës/D.Kursi – 20 pikë - Provim përfundimtar – 60 pikë ndërsa për lëndën Praktikë/internship vlerësimi i studentit sipas peshës përkatëse në përqindje është: - Koordinatori kompani/servis – 40 pikë - Pedagogu mbikqyrës – 20 pikë - Provim përfundimtar – 40 pikë GVJ, në vazhdimësi edhe të analizës së realizuar në standardet më lart, sugjeron t'i kushtohet vëmendje rekomandimeve të dhëna në standardin II.1, kriteri 3. Evidencë Dok 18 Rregullore e KUB_11zon.pdf Evidencë Dok 14. Rregullore e KSLP.pdf Evidencë Dok 15. Rregullore e DSLT.pdf Evidencë Dok 21 Rregullore e Praktikës Profesionale.pdf Evidencë Dok 10 Rregullore e programit të studimit “Teknik i Lartë”.pdf Evidencë Dok 27. Rregullore e provimeve.pdf Evidencë shtesë TL GWMD SYLLABUS 24-25.pdf Evidencë shtesë TL SIST KOMPJ 24-25.pdf Evidencë shtesë TL TIK 2024-2025.pdf			
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-3 të standardit III.2, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se:</i> - <i>Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale janë të përcaktuara në rregulloret institucionale dhe syllabus-et e lëndëve të cilat u bëhen të njohura studentëve javën e parë të çdo semestri akademik.</i> - <i>Pedagogët në fillim të çdo lënde/moduli informojnë studentët për format e vlerësimit të njohurive dhe aftësive, për metodologjinë e testimit, për detyrimet lëndore së bashku me afatet për secilin detyrim që mbështesin vlerësimin formues dhe përmblendhës të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo



studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion GVJ konstaton se testimi dhe vlerësimi i njohurive, aftësive dhe kompetencave profesionale realizohet përgjatë vitit akademik me qëllim që studentët të jenë të angazhuar përgjatë semestrit dhe të vlerësohen sipas disa kriterëve të parashikuara në rregulloren e studimeve. Siç është përmendur edhe më lart pedagogu i lëndës në vlerësimin përfundimtar mbështetet në vlerësimin e vazhduar në seminare, detyrën e kursit, provimin e ndërmjetëm dhe provimin përfundimtar. Këto forma testimi dhe detyrash u japin mundësinë të gjithë studentëve të shprehin aftësitë e tyre dhe të mbrojnë kompetencat e fituara gjatë procesit mësimor. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale parashikohet në të gjitha syllabuset e lëndëve. Evidencë Dok 18 Rregullore e KUB_11zon.pdf Evidencë Dok 14. Rregullore e KSLP.pdf Evidencë Dok 15. Rregullore e DSLT.pdf Evidencë Dok 10 Rregullore e programit të studimit “Teknik i Lartë”.pdf Evidencë Dok 27. Rregullore e provimeve.pdf Evidencë shtesë TL GWMD SYLLABUS 24-25.pdf Evidencë shtesë TL SIST KOMPJ 24-25.pdf Evidencë shtesë TL TIK 2024-2025.pdf
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Nga bisedat që realizoi GVJ me anëtarët e personelit akademik efektiv, por edhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, u konstatua se testimi dhe vlerësimi i njohurive në KUB realizohet duke kombinuar metodat tradicionale (provimet me shkrim dhe ato me gojë), si dhe format elektronike si hartimi, dërgimi elektronik dhe prezantimi i detyrave/projekteve të kursit. Gjithashtu vlen të përmendet implementimi i sistemit Edu4scool, pa afat, i cili do të rrisë transparencën dhe do të lehtësojë punën e sekretarisë mësimore.
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	GVJ konstaton se format e vlerësimit përfundimtar të lëndës janë të përcaktuara përgjithësisht në rregulloren e studimeve në KUB, rregulloren e KSLP, DSLT, të programit të studimit TL, rregulloren e provimeve, si dhe në mënyrë më specifike në syllabus-in përkatës të lëndës. Në të njëjtën kohë forma e vlerësimit u bëhet e ditur studentëve në javën e parë



	mësimore nga pedagogu i lëndës. Evidencë Dok 18 Rregullore e KUB_11zon.pdf Evidencë Dok 14. Rregullore e KSLP.pdf Evidencë Dok 15. Rregullore e DSLT.pdf Evidencë Dok 10 Rregullore e programit të studimit “Teknik i Lartë”.pdf Evidencë Dok 27. Rregullore e provimeve.pdf Evidencë shtesë TL GWMD SYLLABUS 24-25.pdf Evidencë shtesë TL SIST KOMPJ 24-25.pdf Evidencë shtesë TL TIK 2024-2025.pdf Evidencë Dok 52 Formulari i vlerësimit të vazhduar dhe përfundimtar.pdf
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion GVJ konstaton se gjatë zhvillimit të lëndës stafi akademik gjatë orëve të seminareve u ofron studentëve komente /feedback për performancën e tyre lidhur me përvetësimin e njohurive gjatë seminareve/testimeve të ndërmjetme, nivelit të përgatitjes/prezantimeve të detyrave të kursit/projekteve, duke iu dhënë këshilla/orientime për përmirësimin e performancës në të ardhmen. Vlerësimi i komponentëve të vlerësimit përfundimtar shoqërohet me komente nga pedagogu/pedagogët e lëndës, ku qartësohen të gjitha kriteret e përdorura në vlerësim dhe studentët ballafaqohen me vlerësimin. Korrigjimi i provimit shoqërohet me komente në lidhje me gjetjet e pedagogut dhe arsyetimin e vlerësimit. Nga takimi me stafin akademik dhe studentët e programit të studimit u konstatua se në raste të nevojshme, pedagogu/pedagogët e lëndës janë të gatshëm të japin mbështetjen dhe sqarimet shtesë të nevojshme për studentët që e kërkojnë këtë, bazuar edhe në rregulloren e TL. Evidencë Dok 27. Rregullore e provimeve.pdf
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Në rregulloren e provimeve, Neni 13-15, janë përcaktuar masat që merren nga njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik që shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. DSLT dhe personeli akademik bazohen në këtë rregullore lidhur me mënyrën e mbikëqyrjes dhe të masave ndëshkuese në rast kopjimi gjatë procesit të provimit. Për sa i përket detyrave të kursit, personeli akademik dhe drejtuesit e DSLT, orientojnë/miratojnë tematika kryesisht aplikative ose gjysmë aplikative, ku të dhënat që përdoren të jenë. Testi i ndërmjetëm dhe ai final administrohen nga

	prania në auditor e dy pedagogëve, të cilët janë përgjegjës për moslejimin e kopjimit. Evidencë Dok 27. Rregullore e provimeve.pdf
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Nga vizita në institucion, si edhe nga kontrolli i dokumentacionit shoqërues rezultoi se vlerësimi përfundimtar bëhet në përputhje me rregulloren e provimeve, Neni 16, si dhe sipas disa kriterëve të parashikuara për komponentët e vlerësimit në syllabuset e lëndëve. GVJ konstatoi, gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, që vlerësimi kryhet në bazë notash nga 1 në 10. Nota më e ulët kaluese është nota 5. Rezultatet e provimit ju bëhen të njohura studentëve nga pedagogu i lëndës brenda një jave nga data e zhvillimit, përfshirë edhe seancat sqaruese, ndërsa në rastin e riprovimeve periudha kohore është një javë. Evidencë Dok 27. Rregullore e provimeve.pdf
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	GVJ konstatoi gjatë takimit me studentët se ata ishin të informuar mbi të drejtën e tyre për ankimim, kjo e përcaktuar edhe në rregulloren e studimeve të KUB, Neni 98, rregulloren e provimeve, Neni 16, pika 3-6. Gjatë takimit me studentët e këtij programi studimi, GVJ konstatoi se studentët në përgjithësi merrnin përgjigje apo sqaronin çdo paqartësi të mundshme me pedagogët e lëndës pa patur nevojë të përshkallëzojnë kërkesat e tyre. Evidencë Dok 18 Rregullore e KUB_11zon.pdf Evidencë Dok 27. Rregullore e provimeve.pdf
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Në rregulloren e KUB përcaktohet në mënyrë të detajuar procedura e ankimit të vlerësimit: <i>Pas marrjes së vlerësimit, studenti ka të drejtë që brenda 72 orëve të paraqesë ankim me shkrim drejtuar pedagogut të lëndës/modulit, pranë sekretarisë mësimore, e cila e vë në dijeni pedagogun dhe brenda një jave rishikon tezën në prani të studentit dhe plotëson procesverbalin për vlerësimin e studentit. Studentët që nuk janë dakord me vlerësimin e rishikuar kanë të drejtë të paraqesin brenda tre ditëve nga marrja dijeni e vlerësimit, ankesë me shkrim tek drejtuesi i njësisë kryesore përkatëse i cili ia përcejell ankesën drejtuesit të njësisë bazë. Ky i fundit ngre komision ad-hoc për rishikim vlerësimi dhe përcakton vlerësimin përfundimtar, i cili i bëhet i ditur studentit jo më vonë se 5 ditë nga</i>

	<i>paraqitja e kërkesës për rishikim.</i> Megjithatë, GVJ konstaton se në rregulloren e KUB periudha e ankimimit të studentit në sekretari është brenda 3 ditëve nga shpallja e rezultatit ndërsa në rregulloren e provimeve periudha e ankimimit të studentit në sekretari është një afat prej 5 ditësh nga data e shpalljes së rezultatetve. (Neni 16, pika 3) <u>GVJ rekomandon</u> unifikimin e rregullores së provimeve bazuar në rregulloret institucionale ku ajo mbështetet. Evidencë Dok 18 Rregullore e KUB_11zon.pdf Evidencë Dok 27. Rregullore e provimeve.pdf
Konkluzione	<i>Bazuar në analizën e kriterëve 1-8 të standardit III.3, si dhe gjetjet në dokumentacionin e dorëzuar, por dhe në takimet gjatë vizitës në IAL konstatohet se:</i> - <i>Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale parashikohet në të gjitha syllabuset e lëndëve.</i> - <i>Testimi dhe vlerësimi i njohurive në KUB realizohet duke kombinuar metodat tradicionale si dhe format elektronike.</i> - <i>Format e vlerësimit përfundimtar të lëndës janë të përcaktuara në rregulloret institucionale, si dhe në mënyrë më specifike në syllabus-in përkatës të lëndës.</i> - <i>Gjatë zhvillimit të lëndës stafi akademik u ofron studentëve komente /feedback për performancën e tyre lidhur me përvetësimin e njohurive gjatë seminareve/testimeve të ndërmjetme, nivelit të përgatitjes/prezantimeve të detyrave të kursit/projekteve, duke iu dhënë këshilla për përmirësimin e performancës në të ardhmen.</i> - <i>Në rregulloren e provimeve të KUB janë përcaktuar masat që merren nga njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik që shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</i> - <i>Vlerësimi përfundimtar bëhet në përputhje me rregulloren e studimeve në KUB, rregulloren e provimeve si dhe sipas disa kriterëve të parashikuara për komponentët e vlerësimit në syllabuset e lëndëve.</i> - <i>Studentët në përgjithësi marrin përgjigje apo sqarojnë çdo paqartësi të mundshme me pedagogët e lëndës pa patur nevojë të përshkallëzojnë kërkesat e</i>



	tyre. <i>GVJ rekomandon unifikimin e rregullores së provimeve bazuar në rregulloret institucionale ku ajo mbështetet.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale tek ato.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës konstaton se plani mësimor i programit të studimit synon të arrijë kompetenca profesionale në fushat: - Sisteme Kompjuterike, - Teknologji Informacioni, - Grafik, Web dhe Multimedia Dizajn, Në përmbyllje të studimeve zhvillohet Provim Formimi. Ky program synon t'i përgatisë studentët me njohuritë dhe kompetencat e nevojshme në formimin teorik dhe praktik për zhvillimin e aftësive profesionale në funksion të karrierës personale. Programi bazohet në kërkesat aktuale të tregut të punës, konkretisht nëpërmjet moduleve që kanë në qendër thellimin e njohurive në gjuhët e programimit, sistemeve të informacionit, sigurisë, dizenjimin e bazave të të dhënave si edhe analizën dhe përpunimin e tyre. Gjithashtu, në këtë program studimi është parashikuar lënda "Praktikë I" dhe Praktikë II, të cilat synojnë që të aftësojnë studentin të aplikojë në praktikë njohuritë e përfuara gjatë studimeve në një ambient real në tregun e punës. Staf i akademik motivon dhe përfshin studentët në veprimtari jashtë kurrikulare. <i>Evidencë Dok 10 Rregullore e programit të studimit "Teknik i Lartë"</i> <i>Evidencë Dok.36 Planet mësimore për vitin akademik, 2023-2024 dhe 2024-2025</i>
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e	Programi i studimit "Teknik i Lartë", me profile "Sisteme Kompjuterike", "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" dhe "Grafik, Web dhe Multimedia dizajn" garanton një formim profesional të studentëve në fushën e shkencave kompjuterike

teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	si dhe të aftësive specifike në fushën e komunikimit dhe menaxhimit. Për sa më sipër, në planin mësimor të këtij programi studimi, është parashikuar zhvillimi i lëndëve karakterizuese multidisiplinare në teknologjinë e informacionit si: Algoritmike dhe Programim i Avancuar, Baza të Dhënash, Sisteme Shfrytëzimi, Rrjeta Kompjuterike, Ekonomi Biznesi, Administrim Ndërmarrje, Dizajn i Markës, Sociologji, Anglisht etj. Këto lëndë së bashku me të tjera, zhvillojnë aftësitë profesionale të veçanta të studentëve që ndjekin këtë program studimi. <i>Evidencë Dok 10 Rregullore e programit të studimit "Teknik i Lartë"</i> <i>Evidencë Dok.36 Planet mësimore për vitin akademik, 2023-2024 dhe 2024-2025</i>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Nga takimi me studentët e programit, rezultojnë se në fillim të semestrit, studentëve iu ofrohet informacion rreth mënyrës së organizimit të lëndës, objektivat e lëndës, rezultatet e pritshme dhe mënyrat e vlerësimit. Metodatat e testimit dhe vlerësimit të njohurive, aftësive dhe kompetencave profesionale analizohen dhe vlerësohen në përfundim të lëndës. Në këtë mënyrë u evidentohen studentëve konceptet dhe çështjet më të rëndësishme të lëndës, si dhe detyrimet përmbyllëse dhe vlerësimi i tyre sipas kriterëve të parashikuara dhe prezantuar në syllabuset e lëndëve. GVJ u informua gjatë takimit me stafin akademik se nga ana e tyre studentët mbështeten, orientohen dhe udhëzohen në mënyrë të vazhdueshme për realizimin e detyrave e projekteve të caktuara si punë individuale apo në grup. Çdo pedagog, në përfundim të procesit mësimor (në javën e fundit të semestrit), bën një analizë dhe përmbljedhje të të gjithë procesit të realizuar me studentët, duke evidentuar çështjet më të rëndësishme dhe kompetencat e fituara që studentët duhet të demonstrojnë në provim. Studentët orientohen në lidhje me strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë provimi final dhe gjithashtu edhe për peshën që do të ketë në notën finale të modulit provimi final. <i>Dok.Shtese: TL GWMD SYLLABUS 24-25</i> <i>Dok.Shtese: TL SIST KOMPJ 24-25</i> <i>Dok.Shtese: TL TIK 2024-2025</i> <i>Evidencë: Dok 10 Rregullore e programit të studimit "Teknik i</i>



	<i>Lartë”</i> <i>Evidencë: Dok.34. Kurrikula dhe planet mësimore të programit “Teknik i Lartë</i>																																
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Institucioni garanton akses në 2 (dy) laboratorët e informatikës dhe 1 (një) laborator të elektronikës. Në kurrikulën e programit të studimit janë parashikuar orë laboratorike për çdo lëndë përveç lëndëve me karakter bazë formues si: Matematikë, Analizë Matematike, Anglisht, Ekonomi Biznesi dhe Administrim Ndërmarrje. Më poshtë po përmledhim ngarkesën mësimore në auditor sipas aktiviteteve mësimore të zhvilluara brenda lëndëve siç paraqitet në planin mësimor të programit të studimit. <table><tr><th>Profili</th><th>Viti</th><th>Leksione</th><th>Seminare</th><th>Laboratore</th></tr><tr><td rowspan="2">Grafik, Web dhe Multimedia Dizajn</td><td>1</td><td>272</td><td>180</td><td>79</td></tr><tr><td>2</td><td>242</td><td>130</td><td>111</td></tr><tr><td rowspan="2">Sisteme Kompjuterike</td><td>1</td><td>272</td><td>174</td><td>85</td></tr><tr><td>2</td><td>242</td><td>130</td><td>111</td></tr><tr><td rowspan="2">Teknologji Informatike dhe Komunikimi</td><td>1</td><td>272</td><td>174</td><td>85</td></tr><tr><td>2</td><td>242</td><td>130</td><td>111</td></tr></table> Nga tabela me sipër vëmë re rreth 50% e ngarkesës totale në auditor zhvillohet në formën e leksioneve dhe 50% tjetër në formën e Seminareve dhe Laboratorëve. Pra, pjesa praktike zë rreth gjysmën e ngarkesës në auditor. Gjithashtu, plani mësimor përmban modulet Praktike Profesionale I dhe Praktikë Profesionale 2, me nga 5 kredite ECTS secila të cilat zhvillohen përkatësisht në vitin e parë dhe në vitin e dytë. Për të plotësuar kërkesat e parashikuara në lëndët e praktikës profesionale, studentët duhet të zhvillojnë praktikë në një ose disa kompani/servise/studio/zyra apo subjekte private, të cilat përmbushin kushtet për zbatimin e njohurive teorike të marra në auditor. Gjatë takimit me studentët dhe stafin akademik u vu në dukje që në mënyrë të vazhdueshme institucioni nëpërmjet stafit akademik mbështet, orienton dhe instrukton studentët në	Profili	Viti	Leksione	Seminare	Laboratore	Grafik, Web dhe Multimedia Dizajn	1	272	180	79	2	242	130	111	Sisteme Kompjuterike	1	272	174	85	2	242	130	111	Teknologji Informatike dhe Komunikimi	1	272	174	85	2	242	130	111
Profili	Viti	Leksione	Seminare	Laboratore																													
Grafik, Web dhe Multimedia Dizajn	1	272	180	79																													
	2	242	130	111																													
Sisteme Kompjuterike	1	272	174	85																													
	2	242	130	111																													
Teknologji Informatike dhe Komunikimi	1	272	174	85																													
	2	242	130	111																													

	realizimin e projekteve të caktuara si pjesë e programeve mësimore të lëndëve të ndryshme. Studentët cilësuan si pikë të fortë të institucionit komunikimin me pedagogët dh mbështetjen e përfshirjen e tyre në aktivitete pratike jashtë-kurrikulare. Departamenti, në bashkëpunim me studentët, ka mundësuar zhvillimin e praktikës profesionale jashtë auditorit në servise ku punojnë vetë studentët apo në servise me të cilat janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për kryerjen e praktikës profesionale. Këto praktika janë ndjekur nga pedagogët përgjegjës për secilin program. <i>Evidencë: Dok.19 Lista e institucioneve kompanive dhe subjekteve me të cilat KUB ka marrëveshje</i> <i>Evidencë: Dok.20 Lista e kompanive, institucioneve dhe subjekteve me të cilët DSLT ka marrëveshje</i> <i>Evidencë: Dok.21 Rregullore e Praktikës Profesionale</i> <i>Evidencë: Dok.34. Kurrikula dhe planet mësimore të programit "Teknik i Lartë"</i>
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Stafi akademik i DSLT harton metoda interaktive gjatë vitit akademik për të transmetuar njohuritë tek studentët. Shumica e pedagogëve zhvillojnë leksione, orë praktike, dhe praktika mësimore në qendra dhe biznese partnere, si dhe leksione të hapura, për të siguruar që studentët të përvetësojnë njohuritë në mënyrë sa më efikas Gjatë vitit akademik 2023-2024, DSLT ka bashkëpunuar me Zyrën e Karrierës për të mbështetur studentët para, gjatë dhe pas studimeve të tyre nëpërmjet trajnimeve që synojnë orientimi e studentëve në tregun e punës. <i>Evidence: Dok 23. Analizë vjetore e punës së DSLT për vitin akademik 2023-2024</i>
Konkluzione	<i>Departamenti i Studimeve të Larta Teknike (DSLST) me mbështetjen e Kolegjit të Studimeve të Larta Profesionale (KSLT) për studimet e larta profesionale "Teknik i Lartë" me profile "Sisteme Kompjuterike", "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" dhe "Grafik, Web dhe Multimedia Dizajn", janë të angazhuar në përgatitjen e studentët me njohuritë dhe kompetencat e nevojshme në formimin teorik dhe praktik për zhvillimin e aftësive profesionale në fushën e informatikës dhe shkencave kompjuterike. Institucioni nëpërmjet stafit akademik mbështet, orienton dhe instrukton studentët në realizimin e projekteve të caktuara si pjesë e programeve mësimore të</i>



	<i>lëndëve të ndryshme. Ngarkesa në auditor për këtë program studimi mbulohet në masën 50% nga pjesa praktike.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike.	KUB parashikon procesin e diplomimit të studentëve në tërësi në aktet e brendshme rregullatore. Rregullorja e programit të studimit, rregullorja e KSLP dhe ajo e DSLT paraqesin procesin e diplomimit të studentëve që studiojnë në këtë program studimi. Kurrikula e programit të studimit parashikon Provim Formimi me 6 kredite ECTS i cili realizohet me provim të përgjithshëm diplome dhe vlerësohet me notë. Struktura e vitit akademik e bërë publike në fillim të çdo viti akademik mban informacion edhe për periudhën e zhvillimit të provimit të diplomës. Sipas rregullore së programit të studimit, Nenin 18, studentët e programit të studimeve të larta profesionale "Teknik i Lartë me profile" kanë të drejtë të hyjnë në provimin e formimit, vetëm pasi kanë grumbulluar 120 kredite ose me shume. GVJ kujton që programi i studimit me karakter profesional përmban gjithësej 120 kredite, nga të cilat 6 kredite i takojnë Provimit të Formimit. <i>GVJ rekomandon institucionin të përditësojë rregulloren e programit të studimit ku të ketë në vëmendje edhe kriteret dhe procedurat për kryerjen e provimit të formimit.</i> Provimi përfundimtar zhvillohet në përputhje me udhëzimin për kryerjen e provimit të formimit të miratuar nga drejtori i KSLP. <i>Evidencë: Dok 10 Rregullore e programit të studimit "Teknik i Lartë"</i> <i>Evidencë: Dok 14. Rregullore e KSLP</i> <i>Evidencë: Dok 15. Rregullore e DSLT</i> <i>Evidencë: Dok 53 Urdhri i Drejtorit të KSLP, për provime formimi</i> <i>Evidencë: Dok.34. Kurrikula dhe planet mësimore të</i>

	<i>programit "Teknik i Lartë"</i> <i>Evidencë: Dok 45 Struktura e vitit akademik për programin Teknik I Lartë, plani dhe orari mësimor</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Bazuar në rregulloren e programit të studimit Teknik i Lartë, Neni 18, departamenti përgatit pyetjet nga lëndët kryesore dhe i publikon 5 javë para provimit të diplomimit për orientimin e studentëve. Përmes pedagogëve hartohen tezat e provimeve, të cilat miratohen nga Drejtori i KSLP. Po ashtu, propozohet komisioni dhe përgatitet grafiku, i cili pas miratimit afishohet për studentët. <i>Evidencë: Dok 10 Rregullore e programit të studimit "Teknik i Lartë"</i> <i>Evidencë: Dok 54. Seti i pyetjeve përfundimtare në një profil</i> <i>Evidencë: Dok 45 Struktura e vitit akademik për programin Teknik I Lartë, plani dhe orari mësimor</i> <i>Evidence: Dok 76 Guida e studentit</i>
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit/viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Provimi i diplomimit organizohet nga një komision me tre anëtarë që përfaqësojnë profilet e studimit. Ai zhvillohet me gojë dhe synon të vlerësojë njohuritë e fituara nga studentët në të gjitha lëndët, duke u bazuar në konceptet themelore të secilit drejtim akademik. <i>Evidencë: Dok 10 Rregullore e programit të studimit "Teknik i Lartë"</i> <i>Evidencë: Dok 55 Kopje e procesverbalit të provimit të diplomimit për profilin "Teknik i Lartë"</i>
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit përmbyllës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para	NA

komisionit.	
Kriteri 5. Institucioni ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit.	Bazuar në rregulloren e programit të studimit si dhe në rregulloren e praktikës profesionale shpërndarja e studentëve nëpër kompanitë dhe serviset e praktikës kryhet nga përgjegjësi i departamentit dhe pedagogu i praktikës në ditën e parë të javës së praktikës. Shpërndarja e studentëve në çdo kompani/servis/studio, shoqërohet me një shkresë nga drejtori i KSLP për kompaninë/servisin. Në dispozicion të studentit janë edhe të gjitha ambientet laboratorike të departamentit dhe suporti nga stafi akademik dhe ndihmës akademik në qoftë se është e nevojshme. <i>Evidencë: Dok 21 Rregullore e Praktikës Profesionale</i> <i>Evidence Dok 22. Vlerësime të performances së studentëve nga kompanitë dhe serviset ku zhvillojnë</i> <i>Evidence: Dok 76 Guida e studentit</i>
Kriteri 6. Në përfundim të detyrimit përmbyllës, studenti vlerësohet me notë.	Provimi i formimit zhvillohet në përputhje me rregulloret institucionale dhe rregulloren për zhvillimin e provimeve. Departamenti i propozon Drejtorit të KSLP 3 (tre) anëtarët e Komisionit të Provimit Përfundimtar të cili pasi e shqyrton bën miratimin e tij. Komisionit të Provimit Përfundimtar vlerëson me notë Provimin e diplomës. Studenti fiton kreditet ECTS sipas planit mësimor përkatës. <i>Evidencë: Dok 15. Rregullore e DSLT</i> <i>Evidencë: Dok 27. Rregullore e provimeve</i> <i>Evidencë: Dok 55 Kopje e procesverbalit të provimit të diplomimit për profilin "Teknik i Lartë"</i>
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me "Çertifikatë profesionale" ose "Diplomë profesionale" në fushën e arsimimit të kryer, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Bazuar në dokumentacionin e DVV, institucioni i pajis studentët me diplomën, listën e notave dhe suplementin e diplomës sipas formës së miratuar dhe të regjistruar në QSHA (Qendra e Shërbimeve Arsimore). Studentët që përfundojnë me sukses programin profesional "Teknik i Lartë" me profile pajisen me diplomë profesionale, ku pasqyrohet emërtimi i Njësisë Kryesore, programi i studimit dhe profili përkatës. Diplomat shpërndahen gjatë ceremonive të organizuara nën autoritetin e Rektorit. <i>Evidencë: Dok 56 Format diplomës "Teknik i Lartë " në profilet "Sisteme kompjuterike", "Teknologji</i>

Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Bazuar në RVB dhe vizitën në institucion konstatojmë së të gjitha dokumentet e studentëve gjatë studimeve të tyre arkivohen sipas akteve ligjore në fuqi dhe janë në çdo moment në dispozicion të sekretarisë mësimore. Dosja e studentit arkivohet në arkivën e KUB në momentin që studenti diplomohet/çregjistrohet/transferohet. Në rastin e studentëve të diplomuar në KUB, dosjes së studentit i bashkangjitet edhe një fotokopje e diplomës dhe suplementit. Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore, vihet re një organizi i arkivës dhe i materialeve për çdo student, lehtësisht të aksesueshme nga personeli i sekretarisë në çdo moment. <i>Evidencë: Dok 57 Rregullorja e Sekretarisë</i> <i>Evidencë: Dok 70 Rregullore arkivit</i>			
Konkluzione	KUB ka të përcaktuar qartë procedurat e përfundimit të studimeve dhe të diplomimit. Programi i studimeve të larta profesionale "Teknik i Lartë" me profile "Sisteme Kompjuterike", "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" dhe "Grafik, Web dhe Multimedia Dizajn", realizon përmbylljen e studimeve me Provim Formimi, i cili vlerësohet me notë dhe në përfundim të të cilit student fiton 6 kredite ECTS. KUB ka vënë në dispozicion të studentëve procedura të qarta në lidhje me procesin e diplomimit. studentët pajisen me diplomën dhe suplementin e diplomës sipas standardeve të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. GVJ rekomandon institucionin të përditësojë rregulloren e programit të studimit në lidhje me Provimin e Formimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet X

Standardi III.6 Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin	KSLP e zhvillon këtë program studimi në përputhje me standardet e vendosura nga KUB duke harmonizuar punën në auditor me punën individuale të studentit duke shfrytëzuar



dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	gjithë materialet e vëna në dispozicion nga pedagogët si dhe materialet që ofron biblioteka (fizike dhe online). Institucioni ka miratuar me urdhër rektori Udhëzuesin për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative në mësimdhënie të cilin e ka vënë në dispozicion të GVJ. Gjithashtu, KUB përdor një udhëzues për personelin akademik për përdorimin e shërbimit Google for Education. <i>Evidencë: Dok 58. Urdhër Rektori Nr 24, date 05.12.2024</i> <i>Evidencë: Dok 72. Udhëzues për përdorimin e Google Education</i> <i>Evidence: Dok 76 Guida e studentit</i>
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	DSLIT është përgjegjës për realizimin e procesit mësimor për programin e studimeve të larta profesionale “Teknik i Lartë” me profile “Sisteme Kompjuterike”, “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” dhe “Grafik, Web dhe Multimedia Dizajn”, dhe përgjegjësi kryesor për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies. Kjo detyrë drejtohet nga Përgjegjësi i DSLIT. Bazuar në RVB, departamenti kryen kontrole periodike të procesit mësimor duke ndjekur orë të caktuara leksionesh apo seminaresh. GVJ e vlerëson këtë si një praktikë të mirë për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies sidomos për stafin e ri, megjithatë kjo procedurë nuk gjendet e rregulluar në aktet rregullatore institucionale, konkretisht në detyrat e shefit të departamentit. GVJ nuk gjen evidencë për të mbështetur kryerjen e kësaj procedure. <i>GVJ rekomandon institucionin që praktikat që kryen për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies t'i përfshijë në rregulloret institucionale dhe t'i kryejë mbi bazë procedurash transparente.</i> Në nivel institucioni puna për vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik drejtohet nga NjSBC. GVJ u informua se vlerësimi i lektorëve nga studentët realizohet 2 herë në vit. <i>Evidencë: Dok 15. Rregullore e DSLT</i> <i>Evidencë: Dok 26. Rregullore e NjSBC</i> <i>Evidencë: Dok 59 Pyetësor i studentëve dhe pedagogëve nga NjSBC</i>
Kriteri 3. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në	Garantimi i përfshirjes së studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve mundësohet nëpërmjet pyetësorit të vlerësimit të

mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	lektorëve të lëndëve të programit të studimit. Ky pyetësor plotësohet në fund të çdo semestri. Pyetësori është anonim dhe gjithë procesi drejtohet dhe monitorohet nga NJSBC. Garantimi i ankimit të rezultatit të provimit të bazohet në procedurën e përcaktuar në rregullore. KUB përveç angazhimit dhe raporteve periodike të NJSBC, angazhon edhe agjenci të jashtme të pavarura, si IQE (Instituti për Cilësi në Arsim), për të realizuar pyetësorë dhe raportet përkatëse për studentët dhe stafin akademik. <i>Evidencë: Dok 26. Rregullore e NJSBC</i> <i>Evidencë: Dok 51 Raport i NJSBC për vitin akademik 2023-2024</i> <i>Evidencë: Dok. 31, Raporti i IQE_11zon</i> <i>Evidencë: Dok 29 Raporti Vjetor i KUB për vitin akademik 2023-2024 dhe Raporti semestrit parë 2024-2025</i> <i>Evidencë: Dok 59 Pyetësor i studentëve dhe pedagogëve nga NJSBC</i>
Kriteri 4. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Çdo anëtar i personelit akademik informohet me anë të postës elektronike në lidhje me rezultatet e tij për këtë anketim. Rezultatet e anketimit i dërgohen të grupuara sipas njësive përkatëse edhe drejtuesve të njësive bazë dhe njësive kryesore. Bazuar në historikun e vlerësimeve të personelit akademik, përgjegjësit e departamenteve analizojnë rezultatet e ankimit dhe diskutojnë në departament problematikat e identifikuara për përmirësimin e tyre në të ardhmen. Publikimi i raporteve të analizës së pyetësorëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies kryhet nga ana e NJSBC, duke i vënë kështu rezultatet e vlerësimit në dispozicion si të personelit akademik ashtu edhe të studentëve apo dhe gjithë instancave të tjera të interesuara. <i>Evidencë: Dok 59 Pyetësor i studentëve dhe pedagogëve nga NJSBC</i> <i>Evidencë: Dok 51 Raport i NJSBC për vitin akademik 2023-2024</i> <i>Evidencë: Dok 23. Analizë vjetore e punës së DSLT për vitin akademik 2023-2024</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - KSLP e zhvillon programin e studimeve të larta profesionale "Teknik i Lartë" me profile "Sisteme Kompjuterike", "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" dhe "Grafik, Web dhe Multimedia Dizajn"




	<i>në përputhje me standardet e vendosura nga KUB dhe ato shtetërore të cilësisë.</i> - <i>NjsBC drejton në nivel institucioni punën për vlerësimin e aftësive mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</i> - <i>Pyetësorët e vlerësimit të lektorëve të lëndëve të programit të studimeve të larta profesionale “Teknik i Lartë” me profile “Sisteme Kompjuterike”, “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” dhe “Grafik, Web dhe Multimedia Dizajn” mundësojnë përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies dhe të vlerësimit të dijeve.</i> - <i>NJSBC publikon raporte të analizës së pyetësorëve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies.</i> - <i>KUB angazhon edhe agjenci të jashtme të pavarura për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në nivel institucional.</i> <i>GVJ rekomandon institucionin që praktikat që kryen për monitorimin e cilësisë së mësimdhënies t'i përfshijë në rregulloret institucionale dhe t'i kryejë mbi bazë procedurash transparente. Gjithashtu, institucioni të përditësojë rregulloren e programit të studimit në tërësi në përputhje me profilet dhe në vecanti në lidhje me Provimin e Formimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.




Kriteret	Vlerësimi																																																
Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	GVJ konstaton se personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimeve të larta profesionale “Teknik i Lartë” me profile “Sisteme Kompjuterike”, “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” dhe “Grafik, Web dhe Multimedia Dizajn” plotëson kërkesat ligjore në fuqi. Për të mbuluar lëndët mësimore të programit i studimit profesional është angazhuar staf akademik me përgatitje specifike në atë fushë. Personeli akademik që angazhohet në programin e studimeve të larta profesionale “Teknik i Lartë” me profile “Sisteme Kompjuterike”, “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” dhe “Grafik, Web dhe Multimedia Dizajn” ka së paku kualifikimin “Master i Shkencave” duke plotësuar kërkesat ligjore për kualifikimin e stafit akademik. Në tre vitet e fundit akademike (sipas Tabela 6) kemi këtë paraqitje të angazhimit të stafit akademik në këtë program studimi sipas kualifikimeve: <table><caption>Profili Sisteme Kompjuterike</caption><tr><th rowspan="2">Stafi për PS</th><th colspan="2">2023-2024</th><th colspan="2">2024-2025</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Dr.</td><td>1</td><td>-</td><td>4</td><td>-</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>5</td><td>2</td><td>6</td><td>6</td></tr><tr><td>Gjithsej</td><td>6</td><td>2</td><td>10</td><td>6</td></tr></table> <table><caption>Profili Teknologji Informacioni dhe Komunikimi</caption><tr><th rowspan="2">Stafi për PS</th><th colspan="2">2023-2024</th><th colspan="2">2024-2025</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Dr.</td><td>1</td><td>-</td><td>4</td><td>-</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>5</td><td>2</td><td>6</td><td>6</td></tr><tr><td>Gjithsej</td><td>6</td><td>2</td><td>10</td><td>6</td></tr></table>	Stafi për PS	2023-2024		2024-2025		PAE	PAK	PAE	PAK	Dr.	1	-	4	-	Msc.	5	2	6	6	Gjithsej	6	2	10	6	Stafi për PS	2023-2024		2024-2025		PAE	PAK	PAE	PAK	Dr.	1	-	4	-	Msc.	5	2	6	6	Gjithsej	6	2	10	6
Stafi për PS	2023-2024		2024-2025																																														
	PAE	PAK	PAE	PAK																																													
Dr.	1	-	4	-																																													
Msc.	5	2	6	6																																													
Gjithsej	6	2	10	6																																													
Stafi për PS	2023-2024		2024-2025																																														
	PAE	PAK	PAE	PAK																																													
Dr.	1	-	4	-																																													
Msc.	5	2	6	6																																													
Gjithsej	6	2	10	6																																													

	<table><tr><th colspan="5">Profili Grafik Web Multimedia Dizajn</th></tr><tr><th rowspan="2">Stafi për PS</th><th colspan="2">2023-2024</th><th colspan="2">2024-2025</th></tr><tr><th>PAE</th><th>PAK</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>Dr.</td><td>1</td><td>-</td><td>4</td><td>-</td></tr><tr><td>Msc.</td><td>5</td><td>2</td><td>6</td><td>5</td></tr><tr><td>Gjithsej</td><td>6</td><td>2</td><td>10</td><td>5</td></tr></table>	Profili Grafik Web Multimedia Dizajn					Stafi për PS	2023-2024		2024-2025		PAE	PAK	PAE	PAK	Dr.	1	-	4	-	Msc.	5	2	6	5	Gjithsej	6	2	10	5
Profili Grafik Web Multimedia Dizajn																														
Stafi për PS	2023-2024		2024-2025																											
	PAE	PAK	PAE	PAK																										
Dr.	1	-	4	-																										
Msc.	5	2	6	5																										
Gjithsej	6	2	10	5																										
	Evidence: Dok 40 Lista e stafit akademik të DSLT, tituj grada Dok.shtese: CV te stafit akademik Evidence: Tabelat e RVB Teknik i larte – Tabela 7																													
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Vërejmë që ngarkesa e personelit akademik, është përcaktuar në respekt të lirisë akademike dhe në përputhje me ekspertizën përkatëse të stafit akademik. DSLT planifikon çdo vit ngarkesën mësimore për të gjithë anëtarët e personelit akademik. Programi i studimit në dy vitet e fundit akademike është i mbuluar në masën rreth 80% nga staf akademik efektiv (sipas Tabela 12). <table><tr><th>Viti akademik</th><th>PAE</th><th>PAK</th></tr><tr><td>2024-2025</td><td>79.16%</td><td>20.83%</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>83%</td><td>17%</td></tr></table> Evidence: Tabelat e RVB Teknik i larte Evidence: Dok 60. Lista e stafit dhe Ngarkesa Vjetore e Stafit Akademik të Programit “Teknik i Lartë”	Viti akademik	PAE	PAK	2024-2025	79.16%	20.83%	2023-2024	83%	17%																				
Viti akademik	PAE	PAK																												
2024-2025	79.16%	20.83%																												
2023-2024	83%	17%																												
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	GVJ konstaton se në vitet e fundit ka patur qëndrueshmëri të personelit akademik të angazhuar në programin e studimit. Nga takimet me përfaqësues të sektorit të Burimeve Njerëzore GVJ u informua se personeli akademik me kohë të plotë i angazhuar në programin e studimit lidh kontratë pune me afat të caktuar për kategorinë Asistent Lektor dhe me afat të pacaktuar për kategorinë Lektor sipas përcaktimeve ligjore në fuqi. KUB garanton edhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore të personelit akademik të punësuar. Personeli akademik me kontratë angazhohet mbi																													

	bazën e kontratave vjetore ose semestrale. <i>Evidence: Dok 60. Lista e stafit dhe Ngarkesa Vjetore e Stafit Akademik të Programit "Teknik i Lartë"</i>
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Kolegji Universitar i Biznesit ka përcaktuar në Statutin e tij dhe Rregulloren e Marrëdhënieve të Punës procedurat për rekrutimin e personelit në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, VKM për stafet akademike, Kodi i Punës, aktet nënligjore të MAS. Zyra e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për zbatimin e procedurave të rekrutimit të personelit. GVJ verifikoi se kuadri rregullativ i KUB përmban procedura transparente të rekrutimit dhe të vlerësimit të personelit. Kjo mënyrë siguron që kandidatët të plotësojnë kushtet dhe të jenë në nivelin e duhur të kualifikimeve në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. <i>Evidence: Dok 17 Statuti i KUB, kreu 5, neni 41-53</i> <i>Evidence: Dok. 61 Urdhëri i rektorit për ngritjen e grupit ad-hoc, (rekrutim personeli, procedurë</i>
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	Bazuar në vizitën në institucion, GVJ konstaton se zhvillimi i seancave laboratorike mbështetet nga staf ndihmës akademik (laborant). Departamenti i Studimeve të Larta Teknike ka në strukturën e tij 3 (tre) staf ndihmës-akademik përgjegjës për labororet (Tabela 2). Ata kontribuojnë në mirëmbajtjen dhe ndihmojnë stafin akademik gjatë zhvillimit të orëve laboratorike. Përveç stafit ndihmës akademik, për mirëmbajtjen e laboratorëve angazhohet edhe Zyra e IT, ashtu dhe stafi akademik me eksperiencë. <i>Evidence: Tabelat e RVB Teknik i larte</i>
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të	Zyrat përgjegjëse për administrimin e dosjeve të personelit akademik (me kohë të plotë dhe të pjesshme) dhe administrativ, në KUB, është Zyra e Burimeve Njerëzore, Administratës dhe Arkivit (ZBNjAA). GVJ zhvilloi takim me përfaqësues të zyrës së Burimeve Njerëzore. GVJ konstatoi se kjo zyrë bashkërendon punën e saj me njësitë bazë në fakultete në lidhje me përditësimin e të dhënave të stafit akademik. Dosja e PAK në KUB përmban: CV, urdhër emërimi, Kontratën, ID, Kartë shëndeti, Diplomë dhe listë notash, diploma gjuhe të huaj, numër llogarie.

studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës akademik dhe administrativ.	<i>Evidence: Dok 60. Lista e stafit dhe Ngarkesa Vjetore e Stafit Akademik të Programit "Teknik i Lartë"</i> <i>Evidence: Dok. 61 Urdhëri i rektorit për ngritjen e grupit ad-hoc, (rekrutim personeli, procedure</i>
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	KUB ka lidhur një sërë marrëveshesh bashkëpunimi në rang kolegji. Lista e këtyre marrëveshjeve me universitete kombëtare/ndërkombëtare institucione ose kompani mund të gjendet në websitin e KUB https://kub.edu.al/partneret/ DSLIT në kuadrin e zbatimit të marrëveshjeve me subjekte të ndryshme private dhe organizata/institucione të tjera, përcakton staf akademik të dedikuar për të ndjekur nga afër studentët në praktikën profesionale. Ky staf në shumicën e rasteve përbëhet nga staf me kohë të pjesshme i cili vjen nga bizneset në bashkëpunim. <i>Evidence: Dok.19 Lista e institucioneve kompanive dhe subjekteve me të cilat KUB ka marrëveshje</i> <i>Evidence: Dok.20 Lista e kompanive, institucioneve dhe subjekteve me të cilët DSLIT ka marrëveshje</i> <i>Evidence: Dok 21 Rregullore e Praktikës Profesionale</i>
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Ky program studimi ka të parashikuar në planin mësimor lëndën e Praktika I dhe Praktika II të cilat realizohen përkatësisht në vitin e parë dhe në vitin e dytë të studimeve në përfundim të së cilës studenti fiton 5 kredite ECTS. Praktika profesionale realizohet si aktivitet i mbështetur në marrëveshjet e bashkëpunimit që KSLP ka me institucione publike apo private. Bazuar në rregulloren e programit të studimit si dhe në rregulloren e praktikës profesionale njësia bazë cakton një pedagog udhëheqës që asiston studentin dhe garanton cilësinë e rezultateve. Shpërndarja e studentëve në çdo kompani/servis/studio, shoqërohet me një shkresë nga drejtori i KSLP për kompaninë/servisin. Gjatë kryerjes së praktikës, pedagogu përgjegjës i caktuar nga departamenti, ushtron kontroll të vazhdueshëm dhe mban lidhje me subjektin ku kryhet praktika. Pedagogu përgjegjës i praktikës është pjesë e komisionit të vlerësimit të praktikës. Në përfundim të praktikës profesionale përfaqësuesi i kompanisë ku kryhet praktika profesionale, përgatit një

	vlerësim për punën e kryer nga studenti gjatë praktikës profesionale. Ky vlerësim konsiderohet edhe nga komisioni i mbrojtjes së praktikës për studentin përkatës. Vlerësimi nga kompania/servisi ku studenti kryen praktikën bazohet në komponentët e mëposhtëm: - Frekuentimi dhe disiplina, - Aktivizimi në punë, - Njohuri teknike, - Njohuri praktike, - Sjellje e Qëndrim. <i>Evidence: Dok 21 Rregullore e Praktikës Profesionale</i> <i>Evidence: Dok 62. Modele vlerësimi të raportit të praktikës profesionale</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - <i>Personeli akademik, i angazhuar në programin e studimeve të larta profesionale “Teknik i Lartë” me profile “Sisteme Kompjuterike”, “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” dhe “Grafik, Web dhe Multimedia Dizajn”, ka nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit dhe realizimin e procesit mësimor. Fusha kërkimore e personelit akademik është në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve.</i> - <i>Ngarkesa mësimore realizohet në masën rreth 80 % nga personeli akademik efektiv.</i> - <i>Rekrutimi i personelit akademik kryhet nëpërmjet procedurave të mirëpërcaktuara dhe të pasqyruara në aktet rregullatore të KUB.</i> <i>Lëndët e Praktikave Profesionale realizohen si aktivitete të mbështetura në marrëveshjet e bashkëpunimit që KSLP ka me institucione publike apo private. Njësia bazë cakton një pedagog udhëheqës që asiston studentin dhe garanton cilësinë e rezultateve të praktikës profesionale.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet
				X

Standardi IV.2



Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Për realizimin e procesit mësimor janë vënë në dispozicion ambientet e duhura për zhvillimin si të leksioneve e seminareve ashtu edhe të seancave laboratorike për programin e studimit. Në dispozicion të tij janë tre laboratorë. Nga vizita në mjediset e vëna në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimor, GJV konstatoi se ato janë të mjaftueshme, me kushte shumë të mira, ndërsa laboratorët janë të kompletuar me pajisje të viteve të fundit, të mirëmbajtur dhe në kompjuterat përkatës janë instaluar softwarët e duhur për zhvillimin cilësor të procesit mësimor. Institucioni ka 1 sallë për aktivitete promovuese dhe 1 sallë për praktikë lëndore/profesionale, 1 sallë internet, mjedis për fotokopje si dhe zyra për stafin si dhe bibliotekën dhe 1 zyrë informacioni për studentët. <i>Evidence: Dok 63 Relacion mbi Infrastrukturën dhe kapacitetet pritëse</i> <i>Evidence: Tabelat e RVB Teknik i larte – Tabela 16</i>
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Gjatë vizitës në institucion GJV pati mundësinë të njihet me infrastrukturën mësimore në funksion të realizimit të këtij programi studimi. KUB zotëron 4 laboratorë të pajisur me teknologjitë e nevojshme për të realizuar procesin mësimor si dhe praktikat mësimore për lëndë të këtij profili. Gjithashtu, mjediset e zhvillimit të procesit mësimor janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, videoprojektor, si mundësi aksesimi të internetit (lidhje wireless), etj. Sallat kanë hapësirën e nevojshme për të ushtruar mësimdhënien në kushte të mira dhe komode për studentët. Secili mjedis disponon ajrosjen dhe ndriçimin e duhur, sistem mbrojtje nga zjarri edhe ajër të kondicionuar. Ambientet janë të pajisura me banka dhe karrige komode për t'ju përgjigjur edhe qëndrimit me orë të zgjatura në leksione dhe seminare të studentëve. <i>Evidence: Dok 63 Relacion mbi Infrastrukturën dhe kapacitetet pritëse</i> <i>Evidence: Vizita ne institucion</i>
Kriteri 3. Laboratorët,	KUB për lëndët dhe programet e profesionale ka

studiot, atelietë, bazat e praktikës profesionale apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	infrastrukturë të përshtatshme teknologjike me 2 (dy) laboratorë informatike, 1 (një) laborator i mekanikës dhe 1 (një) laborator i elektroteknikës. Laboraret janë të pajisur me infrastrukturën e nevojshme në funksion të grup lëndëve që mbështesin. Të gjithë kompjuterat janë me parametra të larta teknike dhe programe të nevojshme për lëndët. GVJ është e mendimit se kjo infrastrukturë informatike plotëson më së miri kërkesat e moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. <i>Evidence: Dok 63 Relacion mbi Infrastrukturen dhe kapacitetet pritese</i> <i>Evidence: Dok 76 Guida e studentit</i> <i>Evidence: Vizita ne institucion</i>			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Dy laboratorët e informatikës janë të pajisur me programe profesionale dhe mbështesin realizimin cilësor të procesit mësimor me gjithë elementët e tij përbërës. Mirëmbajtja dhe funksionimi korrekt i pajisjeve informatike mundësohet nga angazhimi i personelit ndihmës-akademik dhe akademik me kualifikimin e duhur. <i>Evidence: Dok 63 Relacion mbi Infrastrukturen dhe kapacitetet pritëse</i> <i>Evidence: Vizita ne institucion</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - <i>Mjediset e vëna në dispozicion për zhvillimin e procesit mësimor janë të mjaftueshme, me kushte shumë të mira. Laboratorët janë të kompletuar me pajisje të viteve të fundit, të mirëmbajtur dhe në kompjuterat përkatës janë instaluar softwarët e duhur për zhvillimin cilësor të procesit mësimor.</i> - <i>Infrastruktura informatike plotëson më së miri kërkesat e moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</i> - <i>Mirëmbajtja dhe funksionimi korrekt i pajisjeve informatike mundësohet nga angazhimi i personelit ndihmës-akademik dhe akademik me kualifikimin e duhur.</i> <i>GVJ vlerëson se KUB ka vënë në dispozicion të programit të studimit mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës dhe për formimin praktik.</i>			
Shkalla e përmbushjes së	Nuk	Nuk	Nuk	Nuk



standardit		përmbushet	përmbushet
			X

Standardi IV.3



Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	Një pjesë e konsiderueshme e literaturës bazë dhe ndihmëse, në format fizik dhe digjital, ndodhet në bibliotekën e KUB, në hapësirën e dedikuar fushës së shkencave kompjuterike në mënyrë që studentët të mund të kenë akses të menjëhershëm sipas nevojave. GVJ u informua se literatura bazë është e disponueshme në gjuhën shqipe në formën fizike, kurse literatura ndihmëse dhe tutoriale të ndryshme për vetë veçantinë e këtij programi janë kryesisht në gjuhë të huaj (anglisht). Në rastet kur moduli nuk ka patur një libër të botuar në gjuhën shqipe stafi është angazhuar në përgatitjen e cikleve të leksioneve të cilat i janë vënë në dispozicion studentëve duke u depozituar në librarinë e KUB. <i>Evidence: Syllabus_TIK</i> <i>Evidence: Syllabus_SIST KOMPJ</i> <i>Evidence: Syllabus_Grafik, web multimedia</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	Biblioteka e KUB, është e konceptuar dhe e implementuar në hapësirë me 80 poste leximi dhe e pajisur me laptopë me akses në internet. Në bibliotekë gjenden 7150 tituj në gjuhë shqipe dhe të huaj, në format fizik. Fondi shqip dhe i huaj mbulon të gjithë fakultetet e KUB. <i>Evidence: Dok 65 Rregullore e Bibliotekës së KUB</i> <i>Evidence: Dok 66. Model kërkese për tërheqje materiali nga biblioteka</i> <i>Evidence: Dok 67 Raport vjetor i Bibliotekës për cilësinë e Fondit fizik</i>
Kriteri 3. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën	Biblioteka e KUB është e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe të përshtatshme. Biblioteka përditësohet rregullisht falë donacioneve dhe

shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	fondeve të dedikuara nga institucioni. GVI vëren që biblioteka mbulon të gjitha modulet e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. Në bibliotekë studentët mund të gjejnë në format fizik dhe elektronik edhe leksionet e çdo lënde nga pedagogët përkatës. Në ndihmë të studentëve janë dhe bibliotekat on-line të cilat mundësojnë të sigurohet akses në një literaturë të gjerë dhe të përditësuar në gjuhë të huaj, kryesisht në gjuhën angleze dhe studentët preferojnë këtë opsion. <i>Evidence: Dok 65 Rregullore e Bibliotekës së KUB</i> <i>Evidence: Dok 67 Raport vjetor i Bibliotekës për cilësinë e Fondit fizik</i>
Kriteri 4. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	KUB ka akses në bibliotekën digjitale JSTOR e cila ofron më se 12 milionë artikuj të revistave akademike, 85.000 libra dhe mbi 2 milion dokumente në 75 disiplina. JSTOR është e aksesueshme nga studentët dhe stafi akademik. Biblioteka është e abonuar dhe në revista të tjera shkencore on-line GVI në vizitën e tij në Bibliotekë, konsaton se studentët dhe pedagogët kanë akses të barabartë dhe pa pagesë në bibliotekën digjitale online, që siguron akses në revista akademike, libra dhe burime kryesore. Çdo student e pedagog ka të drejtë anëtarësimi falas në bibliotekë. Informacion i plotë në lidhje me shfrytëzimin e bibliotekës vihet në dispozicion të studentëve edhe nëpërmjet faqes zyrtare web të institucionit. <i>Evidence: Dok 64 Adresa dhe kontrata e Bibliotekës elektronike "J Store". jstor.org ku kanë akses të gjithë</i> <i>Evidence: Dok 67 Raport vjetor i Bibliotekës për cilësinë e Fondit fizik</i> <i>Evidence: https://kub.edu.al/libraria/</i>
Kriteri 5. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve.	GVI konsaton se Biblioteka është e pajisur me poste leximi dhe pajisje kompjuterike, për ofrimin dhe aksesimin në bibliotekën digjitale të kolegjit dhe të bibliotekave online ndërkombëtare duke përbushur nevojat e studentëve. Gjithashtu studentët kanë mundësinë të aksesojnë biblioteka online. Materialet gjenden lehtësisht si fizikisht dhe elektronikisht. <i>Evidence: Vizita në institucion-Takim në Bibliotekë</i> <i>Evidence: Dok. 67. Rregullore e Bibliotekës</i>



	<i>Evidence: Dok 76 Guida e studentit</i>
Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	Biblioteka në KUB është në dispozicion të studentëve, për të gjithë kohëzgjatjen e orarit zyrtar të punës së institucionit. Biblioteka është e hapur nga ora 09:00 deri në 16:00 çdo ditë të javës dhe deri në orën 20:00 të ditëve të Mërkura, të Enjte dhe të Premte. <i>Evidence: Vizita në institucion-Takim në Biblotekë</i> <i>Evidence: Dok 65 Rregullore e Bibliotekës së KUB</i> <i>Evidence: Dok 67 Raport vjetor i Bibliotekes për cilësinë e Fondit fizik</i>
Kriteri 7. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj.	Nga vizita që GVJ zhvilloi në institucion, vërehet një frymë bashkëpunimi mes departamenteve e bibliotekës për rritjen e cilësisë së shërbimit të bibliotekës. Lektorët e lëndëve të programeve të studimit depozitojnë gjithmonë në biblotekë një kopje të materialeve të leksioneve, nëse nuk ka libra si fond fizik. Studentët dhe personeli akademik kanë akses në të gjitha fondet online. Me kërkesën dhe në bashkëpunim me departamentet parashikohen blerjet e reja të titujve të librave duke pasuruar vit pas viti në fondin e saj. Gjendja e bibliotekës është 7150 tituj në gjuhë shqipe dhe të huaj, në formatin letër. GVJ konstaton përpjekje të institucionit për pasurimin e bibliotekës dhe plotësimin e kërkesave të stafit akademik me libra. Vëmendje e veçantë i është kushtuar aksesit në bibliotekat online duke zgjeruar në këtë mënyrë aksesin e studentëve dhe personelit akademik në një literaturë të përditësuar. <i>Evidence: Dok 67 Raport vjetor i Bibliotekes për cilësinë e Fondit fizik</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se</i> - <i>Literatura bazë e programit të studimit është e disponueshme në gjuhën shqipe në formën fizike, kurse literatura ndihmëse dhe tutoriale të ndryshme janë kryesisht në gjuhë të huaj.</i> - <i>Biblioteka është e hapur nga ora 09:00 deri në 16:00 çdo ditë të javës dhe deri në orën 20:00 të ditëve të Mërkura, të Enjte dhe të Premte.</i> - <i>Është siguruar akses në biblioteka online duke zgjeruar në këtë mënyrë aksesin e studentëve dhe personelit akademik në një literaturë të përditësuar.</i>

	<i>Informacioni i plotë në lidhje me shfrytëzimin e bibliotekës vihet në dispozicion të studentëve edhe nëpërmjet faqes zyrtare web të institucionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit.	KUB disponon dhe administron informacionin e duhur për studentët, stafin akademik dhe personelin administrativ përmes një sistem menaxhimi i mirëpërcaktuar në procedura sipas rregullores së institucionit dhe rregulloreve të brendshme të strukturave në funksion të tij. Konkretisht GJV konstaton në këtë drejtim: - Sekretarinë mësimore e cila është përgjegjëse për administrimin e informacionit dhe pasqyrimin e tij në regjistrin themeltar të studentëve, regjistrin e arritjeve akademike të cilat mbahen në forme elektronike dhe në hard copy. - KUB ka krijuar një portal që lejon administratën, pedagogët dhe studentët të komunikojnë dhe ku studentët mund të gjejnë gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me provimet, oraret mësimore, aktivitetet, pedagogët; Aksesin në portal mundësohet nëpërmjet faqes web https://portal.kub.edu.al/hyrje/, ku ofrohet hyrja dedikuar studentëve dhe stafit nëpërmjet adresës email dhe fjalëkalimit të personalizuar. Ndërkohë po punohet për përmirësimin e sistemit të integruar dhe digjitalizuar të informacionit në shërbim të sekretarisë mësimore, studentëve dhe stafit akademik dhe administrativ. Në planin strategjik të KUB është edhe investimi në informatizimin e sistemit të menaxhimit të të dhënave. - Google for Education ka qenë edhe paketa e përdorur nga stafi akademik për procesin mësimor gjatë situatës së Covid-19 ku moduli i komunikimit online Google

	Classroom është përdorur për arritjen e një komunikimi interaktiv student - pedagog. <i>Evidence: Dok 69 Udhëzues për përdorimin e Portalit elektronik të KUB</i> <i>Evidence: Dok 71 Rregullore e sekretarisë</i> <i>Evidence: Dok 72. Udhëzues për përdorimin e Google Education</i> <i>Evidence: Dok 76 Guida e studentit</i>
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	KUB garanton përmes strukturave administrative të ngritura administrimin e informacionit në lidhje me personelin akademik, studentët dhe progresin e programit mësimor. Statuti dhe rregulloret e brendshme përcaktojnë qartë detyrat në lidhje me funksionimin e strukturave të cilat janë përgjegjëse për mbajtjen dhe menaxhimin e dokumentacionit për programin e studimit. Në Zyrën e Burimeve Njerëzore ruhen dhe administrohen informacione për personelin akademik, personelin administrativ dhe partnerët e angazhuar në realizimin e programit. Zyra e Burimeve Njerëzore dhe Zyra e Protokollit janë përgjegjëse për dokumentacionin e personelit akademik (PAE/PAK), stafit administrativ. Sekretaria Mësimore, e cila sipas ligjit, udhëzimeve e rregulloreve të dedikuara për gjithçka lidhet me dokumentimin dhe administrimin e veprimtarisë mësimore. <i>Evidence: Dok 14. Rregullore e KSLP</i> <i>Evidence: Dok 17 Statuti i KUB</i> <i>Evidence: Dok 69 Udhëzues për përdorimin e Portalit elektronik të KUB</i>
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	Stafi dhe studentët e KUB kanë adresa emaili të dedikuara që u mundësojnë akses në informacion dhe dokumente përmes sistemit të brendshëm të menaxhimit PORTAL i KUB. Pedagogët përdorin adresën në formatin <i>iniciali_emrimbiemri@kub.edu.al</i>, ndërsa studentët një adresë të ngjashme <i>emrimbiemri@kub.edu.al</i>. Përmes këtij sistemi, informacioni është i aksesueshëm në çdo kohë, edhe jashtë institucionit. Është hartuar gjithashtu një guidë udhëzuese për përdorimin e sistemit të menaxhimit. <i>Evidence: Dok 69 Udhëzues për përdorimin e Portalit elektronik të KUB</i> <i>Evidence: Dok 72. Udhëzues për përdorimin e Google Education</i>

Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	Midis studentëve dhe personelit akademik ekziston një komunikim interaktiv, si fizik, student-staf akademik gjatë orës së mësimi, ashtu edhe jashtë saj. Portali i KUB siguron module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit. Personeli ka informacion për studentët sipas profileve dhe degëve të studimit, për çdo modul ku është i aktivizuar. Në përfundim të zhvillimit të modulit ruhen rezultatet e secilit student dhe ky informacion i komunikohet çdo studenti në profilet përkatëse. Institucioni përdor edhe faqen online institucionale të KUB lidhur me informacione të detajuara për njoftime të ndryshme lidhur me aktivitete që zhvillohen, mobilitete në kuadër të programeve europiane, tarifa të studimit, informacione të detajuara lidhur me strukturën e vitit akademik dhe të dhëna për fakultetin etj. <i>Evidence: Dok 69 Udhëzues për përdorimin e Portalit elektronik të KUB</i> <i>Evidence: Dok 72. Udhëzues për përdorimin e Google Education</i> <i>Evidence: Dok 76 Guida e studentit</i> <i>Evidence: https://kub.edu.al/</i>
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	Sistemi i menaxhimit aksesohet nëpërmjet adresave personale uniforme me domain të institucionit dhe llogari me akses elektronik personal. Gjithashtu, në dispozicion është portali KUB, faqa zyrtare e KUB ku informacioni është i drejtpërdrejtë në kohë reale si për studentët që duan të informohen ashtu dhe për personelin akademik dhe administrativ që do të informojë. <i>Evidence: Dok 69 Udhëzues për përdorimin e Portalit elektronik të KUB</i> <i>Evidence: Dok 72. Udhëzues për përdorimin e Google Education</i> <i>Evidence: Dok 76 Guida e studentit</i> <i>Evidence: https://kub.edu.al/</i>
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të njësisë përgjegjëse për	Në faqen zyrtare të internetit të KUB gjendet informacion për KUB, programet e studimit, partnerët, aktivitetet e ndryshme. Informacioni i detajuar për programin dhe personelin akademik mund të aksesohet nëpërmjet portalit të KUB ku aksesimi për të intersuarit ofrohet me kërkesë ndaj institucionit. Gjithashtu në KUB, Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, e cila udhëhiqet nga profesorë dhe staf i kualifikuar, njeh të interesuarit me programet, përfitimet,




programin e studimit.	punën dhe perspektivat në të ardhmen. Përveç kësaj zyre, zyra e pranimeve njih të interesuarit dhe ju jep të gjithë informacionin e nevojshëm për programin e studimit, kushtet, dokumentet, tarifat, etj. Informacioni në faqen web ofrohet në dy gjuhë: shqip dhe anglisht. <i>Evidence: RVB per Akreditimin e programit Teknik i larte me profile</i> <i>Evidence: Dok 76 Guida e studentit</i> <i>Evidence: https://kub.edu.al/</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se: - KUB disponon portalin KUB, që bën edhe monitorimin e aktivitetit akademik për programin e studimit. - Informacioni që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre administrohet nga Sekretaria Mësimore dhe zyra e Burimeve Njerëzore. - Studentëve dhe stafit akademik u mundësohet hyrje e dedikuar në portalin KUB nëpërmjet emrit të përdoruesit/emailit dhe fjalëkalimit të personalizuar. - Informacion i detajuar për programin dhe personelin akademik mund të aksesohet nëpërmjet portalit të KUB, Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës, dhe zyrës së pranimeve që njih të interesuarit dhe ju jep të gjithë informacionin e nevojshëm për programin e studimit, kushtet, dokumentet, tarifat, etj. - Informacionet publikohen në dy gjuhë në faqen zyrtare të KUB shqip dhe anglisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton	KUB harton raporte financiare në të cilat paraqiten të

një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	ardhurat sipas burimeve dhe shpenzimet për vitin financiar. Në to raportohet gjithashtu për realizimin e objektivave të institucionit. Menaxhimi i aspekteve financiare në nivel institucioni mbulohet nga Administratori i KUB dhe Bordi i Administrimit duke siguruar edhe komunikimin me Senatin akademik. Raportet financiare nuk detajohen në nivel programi studimi ndaj nuk është i mundur vlerësimi më i detajuar i kostove të programit të studimit. Megjithatë, duke marrë në konsideratë situatën financiare të përgjithshme të KUB, GVJ është i mendimit se është e garantuar mbarëvajtja e programit të studimit për më tepër se një cikël të plotë studimi. <i>Evidence: Dok 74 Relacioni për miratimin e Buxhetit për vitin 2024 dhe afatmesëm</i>
Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	GVJ konstaton se në raportimin e dërguar nga KUB janë të pasqyruara në nivel institucioni plani dhe realizimi i financimeve për burimet njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet për aktivitetin kërkimor shkencor, shpenzime materiale, investime infrastrukturore dhe materiale, detyrimet financiare, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet, shërbimet trajnuese dhe zëra të tjerë. Sipas raportit vjetor të veprimtarisë akademike dhe financiare të KUB 2024 është parashikuar financim për laboratorët pranë KSLP-së, bibliotekën dhe softuerin e integruar për administratë e shërbimet studentore. Po ashtu, 5.48% e shpenzimeve vjetore i janë dedikuar kërkimit shkencor në KUB. Hartimi i buxhetit merr parasysh kërkesat që vijnë nga njësitë bazë. <i>Evidence: Dok 74 Relacioni për miratimin e Buxhetit për vitin 2024 dhe afatmesëm</i>
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Analiza financiare dhe realizimi i zërave të investimit dhe shpenzimet është subjekt i kontrolleve periodike nga Administratori i institucionit dhe Zyra e Programimit dhe Raportimit Financiar. Institucioni i nënshtrohet në mënyrë periodike auditimit të brendshëm organizuar nga strukturat përkatëse në varësi të drejtpërdrejtë të Bordit të Administrimit të KUB dhe auditimit të jashtëm ushtruar nga



	strukturat shtetërore financiare dhe Ministria e Arsimit dhe Sporteve. Auditimi i jashtëm i Pasqyrave Financiare të KUB, prej disa vitesh kryhet nga Kompania Ndërkombëtare të Auditimit "Grant Thornton". Sipas RVB, gjetjet dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm, paraqiten për diskutim dhe vendimmarrje në organet drejtuese të KUB, në Senatin Akademik, apo në Bordin e Administrimit. <i>Evidence: Dok 74 Relacioni për miratimin e Buxhetit për vitin 2024 dhe afatmesëm</i> <i>Evidence: Dok 75 Raporti Grand Thorton. (Auditim i jashtëm)</i>
Kriteri 4. Institucioni të raportojë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Informacioni i pasqyruar, mbi realizimin e buxhetit të miratuar, në faqen web të KUB është në nivel institucional. Gjatë vizitës në institucion, dhe në veçanti në takimin me stafin akademik, GVJ konstatoi se personeli akademik ishte i informuar rreth mundësive të mbështetjes financiare institucionale për avancimin e tyre akademik, si mbështetje për pjesëmarrje në konferenca apo për botime në revista. <i>Evidence: https://kub.edu.al/dokumenta-te-rendesishem/</i> <i>Evidence: Dok 49 Plani i veprimit të DSLT për vitet akademike 2023-2024 dhe 2024-2025</i>
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	GVJ konstaton se nga të dhënat e publikuara në faqen e KUB në dokumentat e raporteve financiare për të ardhurat dhe financimet për tre vitet e fundit, institucioni garanton qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e veprimtarisë së tij akademike dhe ecurinë normale të programeve të studimit. Shpenzimet në KUB nuk i kalojnë të ardhurat e realizuara. <i>Evidence: Dok 74 Relacioni për miratimin e Buxhetit për vitin 2024 dhe afatmesëm</i> <i>Evidence: Tabelat e RVB Teknik i larte – Tabela 18</i> <i>Evidence: https://kub.edu.al/dokumenta-te-rendesishem/</i>
Konkluzione	- KUB rezulton se ka kapacitete të mjaftueshme financiare për të realizuar objektivat e tij lidhur me programin e studimit.

	- Pjesa më e madhe e financimit vjen nga të ardhurat e studentëve, ndaj duhen bërë përpjekje për rritjen e peshës së të ardhurave të krijuara nga marrëdhëniet me palët e treta dhe nga grantet për kërkim dhe kontratat. - Nuk ka një detajim deri në nivel programi studimi për të mundësuar një vlerësim më të detajuar të kostove të programit të studimit. Nisur nga situata financiare e përgjithshme e KUB, GVJ mendon se institucioni garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit për më tepër se një cikël të plotë studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Pranimi i studentëve, përparimi i tyre përgjatë programit të studimit, vlerësimi i dijeve dhe diplomimi mbështeten në Statutin e KUB, Rregulloren e KUB, Rregulloren e KSLP, Rregulloren e DSLT dhe Rregulloren e programit të studimit. Nga takimet në institucion, GVJ konstatoi se veprimtaria e KSLP zhvillohet në përputhje me këto rregullore, të cilat janë hartuar në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi dhe se u garantohet barazia dhe të drejta të njëjta të gjithë kandidatëve për studentë dhe studentëve që ndjekin studimet në këtë program studimi. GVJ gjen hartimin e dokumenteve bazë institucionale në përputhje me Ligjin 80/2015 "Për

	Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe zbatimit të udhëzimeve e MASR nr.10 datë 15.05.2019, nr.17 datë 30.07.2019. <i>Evidence: Dok 10 Rregullore e programit të studimit “Teknik i Lartë”</i> <i>Evidence: Dok 14. Rregullore e KSLP</i> <i>Evidence: Dok 15. Rregullore e DSLT</i> <i>Evidence: Dok 17 Statuti i KUB</i> <i>Evidence: Dok 18 Rregullore e KUB</i>
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	GVJ konstaton zbatimin e procedurave që garantojnë barazinë për çdo student. Procedura dhe kriteret specifike që lidhen që me pranimin në këtë program studimi, ndjekjen e procesit mësimor, vlerësimin e studentit e deri në diplomim bëhen publike sipas akteve rregullatore të hartuara nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe të miratuara në njësinë bazë, atë kryesore dhe në Senatin Akademik të KUB. Veprimtaria mësimore organizohet dhe realizohet nga DSLT dhe drejtohet e kontrollohet nga autoritetet dhe organet drejtuese përkatëse me kompetenca të përcaktuara në rregulloret përkatëse. <i>Evidence: Dok 10 Rregullore e programit të studimit “Teknik i Lartë”</i> <i>Evidence: Dok 14. Rregullore e KSLP</i> <i>Evidence: Dok 15. Rregullore e DSLT</i> <i>Evidence: Dok 17 Statuti i KUB</i> <i>Evidence: Dok 18 Rregullore e KUB</i> <i>Evidence: https://kub.edu.al/kolegji-i-studimeve-te-larta-profesionale/</i>
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve për t’u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	Kolegji i studimeve të larta profesionale në KUB do të pranojë studentë në programet e studimit të ciklit të parë, referuar nivelit 5 të kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, në përputhje me përcaktimet e nenit 72 të Ligjit Nr 80/2015 ” Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë. Përcaktimi i kriterëve pranues në programin e studimeve të larta profesionale “Teknik i Lartë” me profile “Sisteme Kompjuterike”, “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” dhe “Grafik, Web dhe Multimedia Dizajn”, kalon për miratim në të gjitha njësitë përgjegjëse për këtë program

	studimi (DSLIT, KSLP, Rektorat, Senat Akademik i KUB, MAS) dhe vihet në dispozicion të publikut në faqen elektronike zyrtare të KUB. Për dy vitet e fundit akademike regjistrimet për programin e studimeve të larta profesionale “Teknik i Lartë” me profile “Sisteme Kompjuterike”, “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” dhe “Grafik, Web dhe Multimedia Dizajn” kanë qënë si më poshtë: <table><tr><th>Viti akademik</th><th>Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë</th><th>Nr. i studentëve të transferuar Viti I</th><th>Nr. i studentëve të transferuar Viti II</th></tr><tr><td>2023-2024</td><td>25</td><td>-</td><td>-</td></tr><tr><td>2024-2025</td><td>24</td><td>-</td><td>-</td></tr></table> <i>Evidence: Dok 43 Guida e studentit, fletë palosja</i> <i>Evidence: Dok 76 Guida e studentit</i> <i>Evidence: Tabelat e RVB Teknik i larte – Tabela 21</i> <i>Evidence: https://kub.edu.al/pranimet/</i>	Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Nr. i studentëve të transferuar Viti I	Nr. i studentëve të transferuar Viti II	2023-2024	25	-	-	2024-2025	24	-	-
Viti akademik	Nr. i studentëve të regjistruar për herë të parë	Nr. i studentëve të transferuar Viti I	Nr. i studentëve të transferuar Viti II										
2023-2024	25	-	-										
2024-2025	24	-	-										
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimiit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimiit përgjatë kursit të studimit, të transferimiit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësiit të dijeve dhe të diplomimiit janë lehtësiit të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Rregulloret e institucionit, njësisë kryesore dhe programit të studimit kanë informacion të plotë për procedurat e pranimiit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimiit përgjatë kursit të studimit, të transferimiit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësiit të dijeve dhe të diplomimiit. Këto informacione, studentët mund ti gjejnë në zyrat përkatëse në institucion dhe në faqen zyrtare të KUB. <i>Evidence: Dok 10 Rregullore e programit të studimit “Teknik i Lartë”</i> <i>Evidence: Dok 14. Rregullore e KSLP</i> <i>Evidence: Dok 15. Rregullore e DSLT</i> <i>Evidence: Dok 17 Statuti i KUB</i> <i>Evidence: Dok 18 Rregullore e KUB</i> <i>Evidence: https://kub.edu.al/pranimet/</i> <i>Evidence: https://kub.edu.al/kolegji-i-studimeve-te-larta-profesionale/</i>												
Kriteri 5. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti	Institucioni, sipas neneve 60 dhe 61 të Rregullores së KUB, përpara çdo viti akademik harton dhe publikon kritere të												

akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, pakica dhe shtresa të marginalizuara. Këto kritere bazohen në kërkesat për kuota që i dërgohen MAS. Referuar takimeve në institucion dhe dosjes së vetëvlerësimit, GVJ konstatoi se pjesë e informimit dhe udhëzimit të publikut janë dhe takime informuese me të interesuarit ku ofrohen edhe informacionet nëpërmjet broshurave dhe mjeteve të tjera si reklamat televizive, ato radiofonike si edhe informimi në zyrat e shërbimit në institucion, pjesëmarrjen në evente dhe panaire lidhur me fushën e arsimit, publikimin në gazeta dhe revista, flyers, postera, prezantime, në lidhje me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit në programin e studimeve të larta profesionale “Teknik i Lartë” me profile “Sisteme Kompjuterike”, “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” dhe “Grafik, Web dhe Multimedia Dizajn”. <i>Evidence: Dok 43 Guida e studentit, fletë palosja</i> <i>Evidence: Dok 76 Guida e studentit</i> <i>Evidence: Dok 77 Udhëzim i MAS, Nr 12, datë 30.06.2023, “Për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit</i>
Kriteri 6. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	Referuar takimeve në institucion, dosjes së vetëvlerësimit dhe RVB, KUB aplikon politika për bursat studentore për shtresat në nevojë si dhe për studentët me rezultate të larta akademike. KUB ofron bursa të plota ose të pjesshme për maturantët me mesatare të lartë, sipas një skeme të gradëzuar. Studentët me mesatare nga 8.5 deri në 10 përfitojnë nga 10% deri në 100% bursë. <i>Evidence: Dok 76 Guida e studentit</i> <i>Evidence: Dok 74 Relacioni për miratimin e Buxhetit për vitin 2024 dhe afatmesëm</i> <i>Evidence: RVB per Akreditimin e programit Teknik i larte me profile</i> <i>Evidence: https://kub.edu.al/pranimet/#bursat</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se: - KLST u garanton barazi dhe të drejta të barabarta të gjithë kandidatëve për studentë dhe studentëve që ndjekin studimet në programin e studimit. - Kriteret dhe procedurat e regjistrimit bazohen në legjislacionin në fuqi dhe shpallen pas miratimit të tyre në Senatin Akademik dhe aprovimit prej MAS.

	<i>Kriteret dhe procedurat janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</i> - <i>Në faqen web të KUB publikohen kriteret për kandidatët.</i> - <i>KUB aplikon politikat për bursat studentore për shtresat në nevojë si dhe për studentët me rezultate të larta akademike.</i> <i>GVJ vlerëson se KUB/KSLP/DSLTL kanë hartuar, ndjekin dhe zbatojnë politika, strategji dhe procedura për të gjithë rrugëtimin e studentëve që nga faza kur janë akoma kandidatë për studentë dhe pastaj për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet
				X

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	Ndër mënyrat për të marrë informacion të plotë, në KUB, në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, janë: - Faqja zyrtare e internetit. - Sekretaria mësimore e cila ju jep informacion të detajuar studentëve për lëndët, kreditet, kalimin në vitin e dytë të studimeve. - Java e orientimit për studentët ku ata informohen për programin mësimor, ambientet, detyrimet dhe të drejtat e studentëve. - Departamenti i Studimeve të Larta Teknike (DSLTL) Burime bazë të informimit janë rregulloret e institucionit (Rregullorja e KUB. Rregullorja e KSLP, Rregullorja e DSLTL) si dhe Rregullorja e programit të studimit. Në to jepen elementë të tillë si pranimi në programin e studimit, pezullimi i studimeve, mobiliteti studentor, viti akademik dhe organizimi i mësimdhënies, organizimi i semestrave mësimor, organizimi i grupeve mësimore, procesi i

	regjistrimit për frekuentimin e kursit, frekuentimi i orëve mësimore, kontrolli i dijeve, zhvillimi i provimeve gjatë emestrit, organizimi i sezoneve të riprovimeve, rregullat e provimit, ankimimi i provimeve, përmirësimi i notës, praktikat profesionale, organizimi dhe vlerësimi i provimit të përgjithshëm përfundimtar të diplomës etj. <i>Evidence: Dok 10 Rregullore e programit të studimit "Teknik i Lartë"</i> <i>Evidence: Dok 14. Rregullore e KSLP</i> <i>Evidence: Dok 15. Rregullore e DSLT</i> <i>Evidence: Dok 17 Statuti i KUB</i> <i>Evidence: Dok 18 Rregullore e KUB</i> <i>Evidence: Dok 76 Guida e studentit</i> <i>Evidence: https://kub.edu.al/kolegji-i-studimeve-te-larta-profesionale/</i>
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme.	Institucioni garanton procedurat për njohjen dhe ekuivalentimin e kualifikimeve. Kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve nga studime të mëparshme janë të pasqyruar në rregulloren e KSLP, rregulloren e DSLT, rregulloren e programit të studimit dhe Rregulloren për Ekuivalentimin e Studimeve për ransferimet apo edhe kualifikimet e kryera me parë. Gjithashtu gjatë regjistrimit të studentëve sekretaria mësimore i informon ata në lidhje me mundësinë e transferimit të krediteve dhe i udhëzon për procedurat që duhet të ndjekin në rastet kur kanë kryer studime të mëparshme. <i>Evidence: Dok 10 Rregullore e programit të studimit "Teknik i Lartë"</i> <i>Evidence: Dok 14. Rregullore e KSLP</i> <i>Evidence: Dok 15. Rregullore e DSLT</i> <i>Evidence: Dok 18 Rregullore e KUB</i> <i>Evidence: Dok 42. Rregullore e transferimit të programeve</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Elementët e detajuar për lëndët që bëjnë pjesë në programin e studimit, jepen nga pedagogët në orën e parë të mësimi, duke u bërë të njohur dhe vënë në dispozicion të studentëve syllabusin e lëndës dhe duke detajuar objektivat e lëndës, temat përkatëse, elementët formues të programit (leksione, ushtrime, detyra kursi, laboratorë et.), mënyrën e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve si dhe literaturën përkatëse. Studentët informohen në lidhje me kriteret e procedurat e

	vlerësimit të dijeve e aftësive të tyre dhe nëpërmjet rregullores së programit të studimit, të sekretarisë dhe të provimeve. <i>Evidence: Dok 10 Rregullore e programit të studimit "Teknik i Lartë"</i> <i>Evidence: Dok 27. Rregullore e provimeve</i> <i>Evidence: Syllabus_Grafik, web multimedia</i> <i>Evidence: Syllabus_SIST KOMPJ</i> <i>Evidence: Syllabus_TIK</i>
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit.	Në rregulloren e programit të studimit, Neni 18, përcaktohet se diplomimi bëhet me provim përfundimtar formimi. Studentët që përfundojnë vitin e dytë akademik dhe kanë përmbushur detyrimet akademike e financiare, i nënshtrohen provimit të diplomës. Ky provim organizohet nga një komision i caktuar nga Drejtoria me propozim të DSLT. Procedura u shpjegohet studentëve përmes sesioneve orientuese. <i>Evidence: Dok 10 Rregullore e programit të studimit "Teknik i Lartë"</i> <i>Evidence: Dok 27. Rregullore e provimeve</i> <i>Evidence: Dok 53 Urdhri i Drejtorit të KSLP, për provime formimi</i> <i>Evidence: Dok 54. Seti i pyetjeve përfundimtare në një profil</i>
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit	Bazuar në dokumentat e dosjes së vetëvlerësimit dhe portalin e KUB, institucioni publikon udhëzues studentorë dhe përgatit fletëpalosje në mënyrë periodike. Këta udhëzues informojnë të interesuarit dhe studentët e ardhshëm edhe mbi programet e studimit në KUB. Institucioni merr pjesë në panairët e edukimit të zhvilluara nga MAS si p.sh. Panairi Work & Study. Gjithashtu. KUB organizon në mënyrë periodike leksione të hapura, trajnime & konkurse dhe aktivitete të ndryshme. Këto aktivitete bëjnë të mundur që të interesuarit dhe studentët e ardhshëm të njihen nga afër me KUB dhe programet e studimit që institucioni ofron. <i>Evidence: Dok 76 Guida e studentit</i> <i>Evidence: Dok 43 Guida e studentit, fletë palosja</i> <i>Evidence: https://kub.edu.al/</i>
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - KUB vë në dispozicion të studentëve të programit të

	<i>studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi programin e studimeve, syllabuset, përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në programit të studimit.</i> - <i>Institucioni garanton procedurat për njohjen dhe ekuivalentimin e kualifikimeve.</i> - <i>Pedagogët u bëjnë të njohur dhe u vënë në dispozicion studentëve syllabusin e lëndës duke detajuar objektivat e lëndës, temat përkatëse, elementët formues të programit, mënyrën e shlyerjes si dhe literaturën përkatëse.</i> - <i>Faqja web e KUB luan një rol të rëndësishëm në informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</i> - <i>Burimet bazë të evidentuara të informimit janë rregulloret e institucionit, Rregullorja e KUB. Rregullorja e KSLP, Rregullorja e DSLT si dhe Rregullorja e programit të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	Gjatë takimit me studentët, GVJ konstatoi se ata janë të informuar në lidhje me strukturën e programit të studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e tij. Studentët informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij që në fillim. Një pjesë e informacionit, si orari mësimor, struktura mësimore, data provimesh, konsultime, etj., është i aksesueshëm edhe nëpërmjet portalit të KUB, si dhe nëpërmjet klasave virtuale të krijuara nga pedagogët (Google Classroom). Sekretaria mësimore gjithashtu ofron informacion të

	përgjithshëm mbi programin e studimit si dhe kurrikulën e programit të studimit, ku pasqyrohet qartë lista e lëndëve, kreditet për çdo lëndë, shpërndarja e tyre sipas semestrave dhe tipologjia (me detyrim ose me zgjedhje). <i>Evidence: Dok 45 Struktura e vitit akademik për programin Teknik I Lartë, plani dhe orari mësimor</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Portali KUB dhe klasat virtuale të krijuara nga pedagogët (Google Classroom) janë disa nga format me anë të të cilave studentët informohen dhe gjejnë informacion të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Gjithashtu një informacion të plotë për lëndët, studentët e marrin në javën e parë të zhvillimit të çdo moduli përkatës nga pedagogu i lëndës. <i>Evidence: Dok 45 Struktura e vitit akademik për programin Teknik I Lartë, plani dhe orari mësimor</i> <i>Evidence: Dok 69 Udhëzues për përdorimin e Portalit elektronik të KUB</i> <i>Evidence: Dok 76 Guida e studentit</i>
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Një rol të veçantë në drejtim të informimit të studentëve mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës luan Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës. Ndër detyrat e kësaj zyre është t'ju ofrojë studentëve edhe leksione të hapura si mund të aplikojnë për punësim, t'ju ofrohen mundësi punësimi dhe rekomandime konkrete për të realizuar intervista punësimi etj. KUB gjithashtu duke i mundësuar studentëve kryerjen e praktikave profesionale, falë bashkëpunimeve dhe partneriteteve që ka me kompanitë dhe organizatat e studiove profesionale sipas profileve të programit të studimit i njeh ata me tregun e punës dhe ofertat e punësimit. <i>Evidence: Dok.20 Lista e kompanive, institucioneve dhe subjekteve me të cilët DSLT ka marrëveshje</i> <i>Evidence: Dok.19 Lista e institucioneve kompanive dhe subjekteve me të cilat KUB ka marrëveshje</i> <i>Evidence: Dok 24 Rregullore e ZSKK (Zyra për Këshillim të Studentit dhe Karrierën)</i>
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e	Studentëve të programit të studimit, nëpërmjet faqes zyrtare të KUB, u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në

procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	funksion të realizimit të tij. Informacioni për ambientet ku do zhvillohet mësimi janë gjatë gjithë kohës të aksesueshme nga studentët në portalin KUB. Sekretaria mësimore gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në lidhje me informimin e studentëve për regjistrimet, pagesat, notat etj. <i>Evidence: Dok 69 Udhezues per perdorimin e Portalit elektronik te KUB</i> <i>Evidence: Dok 76 Guida e studentit</i> <i>Evidence: Dok 45 Struktura e vitit akademik për programin Teknik I Lartë, plani dhe orari mësimor</i> <i>Evidence: https://kub.edu.al/libraria/</i> <i>Evidence: https://kub.edu.al/studio-ne-kub/</i> <i>Evidence: https://kub.edu.al/kampusi-yne/#infrastruktura</i> <i>Evidence: https://kub.edu.al/kampusi-yne/#labororet-e-informatikes</i> <i>Evidence: https://kub.edu.al/?s=praktika</i>
Kriteri 5. Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizimit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës.	Studentët mund të aksesojnë të gjithë informacionin që dëshirojnë rreth programit të studimit, vlerësimit, detyrave, orarit etj nëpërmjet faqes web të institucionit dhe nëpërmjet portalit të KUB, i cili është lehtësisht i arritshëm edhe në distancë. <i>Evidence: Dok 69 Udhezues per perdorimin e Portalit elektronik te KUB</i> <i>Evidence: Dok 76 Guida e studentit</i>
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Studentët e programit të studimit informohen në mënyrë të detajuar nga ana e pedagogëve përkatës në lidhje me zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. - KUB shpërndan informacion edhe nëpërmjet faqes zyrtare web duke informuar studentët në lidhje me programet e studimit dhe detyrat dhe përgjegjësitë që ata kanë. - Sekretaria mësimore gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në lidhje me informimin e studentëve. - Një rol të rëndësishëm në drejtim të informimit të

	<i>studentëve mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës luan dhe Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës.</i> <i>Portali KUB, ofron informacion në lidhje me programin e studimit dhe është lehtësisht i arritshëm edhe në distancë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi			
Kriteri 1. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Mbajtja e statistikave për numrin e studentëve të diplomuarve në programin e studimit kryhet nga sekretaria mësimore e KSLP. Të dhënat përpunohen nga sekretaria mësimore dhe ruhen si në format fizik, regjistrat themeltar, regjistrat e lëshimit të diplomave ashtu dhe në format elektronik. Aktualisht për këtë program studimi <u>nuk ka të dhëna</u> në lidhje me numrin e të diplomuarve sepse <u>ky program akreditohet për herë të parë.</u> GVJ zhvilloi një vizitë në Sekretarinë Mësimore dhe konstatoi se plotësimi i regjistrat themeltar dhe regjistrat të lëshimit të diplomave janë në përputhje me standardet dhe udhëzimet e MAS. Në vizitën që GVJ bëri në sekretarinë mësimore ku verifikoi të dhënat e studentëve konstatohet që numri i studentëve të regjistruar për dy vite akademike për programin e studimit me karakter profesional “Teknik i lartë” me profile është si më poshtë:			
	Viti akademik	Profili Sisteme Kompjuterike	Profili Teknologji Informacioni dhe komunikimi	Profili Grafik, Web dhe multimedia dizajn
	2023-2024	5	12	7
	2024-2025	9	15	0

	<i>Konstatohet që të dhënat e verifikuara nga GVJ në sekretarinë mësimore nuk korespondojnë me evidencat e dorëzuara nga institucioni (shiko tabelën Standardi V.1 Kriteri 3). Sugjerohet institucioni të verifikojë paraprakisht informacionin që dorëzohet zyrtarisht në ASCAL.</i> <i>Evidence: Tabelat e RVB Teknik i lartë – Tabela 21</i> <i>Evidence: Minutat e takimit</i>
Kriteri 2. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Të dhënat në lidhje me studentët mbahen në formë elektronike dhe në format letër. Sekretaria mësimore është përgjegjëse për mbledhjen e informacionit dhe administrimin e dokumentacionit për çdo student që në momentin e regjistrimit të tij deri në përfundim të studimeve. Kjo strukturë administron të dhëna në lidhje me procedura e transferimit dhe ç’regjistrimet që mund të ketë gjatë vitit akademik. Të dhënat pasqyrohen në regjistrin themeltar të studentëve, regjisitri i gjeneraliteteve dhe notave, dhe regjistrat e lëndëve semestrale. Për dy vitet e fundit akademike regjistrimet për programin e studimeve të larta profesionale "Teknik i Lartë", me profile "Sisteme Kompjuterike", "Teknologji Informacioni dhe Komunikimi" dhe "Grafik, Web dhe Multimedia dizajn" kanë qënë si më poshtë: Gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore GVJ u njoh me dokumentacionin që ka të bëjë me studentët e pranuar në programin e studimit dhe e gjeti atë në përputhje me standardet dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi. <i>Evidence: Tabelat e RVB Teknik i lartë – Tabela 21</i>
Kriteri 3. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me	Sekretaria mësimore disponon gjithë informacionin për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. Këto të dhëna disponohen në format letër, në regjistrat përkatës, si dhe në format elektronik, gjë që bën që ky informacion të jetë lehtësisht i aksesueshëm. Kryesekretarja e KUB, sipas nenit 33 të rregullores së KUB, ka rol koordinues dhe kryen kontrole periodike mbi sekretarinë mësimore. Ajo verifikon menaxhimin e brendshëm, dokumentacionin e studentëve dhe problematikat përkatëse, duke hartuar propozime që i paraqet instancave drejtuese të institucionit.

veprimtarinë e tyre përkatëse.	<i>Evidence: Dok 18 Rregullore e KUB</i> <i>Evidence: RVB per Akreditimin e programit Teknik i larte me profile</i>						
Kriteri 4. Njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Departamenti dhe Sekretaria mësimore disponojnë informacionin mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, ndërsa Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK) analizojnë gjendjen e punësimit të studentëve. Këta elementë janë objekt i analizave (përgjithësisht vjetore) si në nivel Departamenti ashtu dhe instanca të tjera. Në përputhje me udhëzimet e MAS, të dhënat përpunohen në nivel institucional dhe një raport vjetor dorëzohet pranë MAS në fund të çdo viti akademik. Të dhënat për cilësinë në hyrje paraqiten si vijon: <table><tr><td>Viti akademik</td><td>2023-2024</td><td>2024-2025</td></tr><tr><td>Nota mesatare në hyrje</td><td>5.7</td><td>6.0</td></tr></table> Programi i studimit akreditohet për herë të parë, rrjedhimisht nuk ka studentë të diplomuar dhe as statistika në lidhje me punësimin e tyre. Megjithatë, në rang institucional, ZSKK mban kontakte të vazhdueshme me studentët e diplomuar, i mban ata të informuar, i fton në takime dhe aktivitete brenda dhe jashtë institucionit. <i>Evidence: Dok 23. Analizë vjetore e punës së DSLT për vitin akademik 2023-2024</i> <i>Evidence: Dok 80 Raport i Zyrës së Studentit dhe Këshillimit të Karrierës</i> <i>Evidence: Tabelat e RVB Teknik i larte – Tabela 21 dhe Tabela 23</i>	Viti akademik	2023-2024	2024-2025	Nota mesatare në hyrje	5.7	6.0
Viti akademik	2023-2024	2024-2025					
Nota mesatare në hyrje	5.7	6.0					
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - Sekretaria mësimore mban statistika për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit. Të dhënat përpunohen dhe ruhen si në format fizik, regjistrat themeltar, regjistrat e lëshimit të diplomave, ashtu dhe në format elektronik. - Sekretaria mësimore disponon gjithë informacionin për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. - Departamenti dhe Sekretaria mësimore disponojnë						

	informacionin mbi cilësinë në hyrje dhe në dalje të studentëve, ndërsa ZSKK analizon gjendjen e punësimit të studentëve. Programi i studimit akreditohet për herë të parë. Të dhënat e punësimit mungojnë sepse studentët nuk janë diplomuar ende. Bazuar në eksperiencën e KUB me programe të tjera studimi, GVJ vlerëson se KUB/KSLP dhe DSLT mbledhin, administrojnë, përditësojnë dhe ruajnë të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin, profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre. Këto të dhëna menaxhohen dhe kontrollohen vazhdimisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	GVJ konstaton se KUB ka parashikuar përfshirjen dhe angazhimin e studentëve (përfaqësuesve të tyre) në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. Këshillat e studentëve (Neni 73 në Statutin e KUB) janë organizime të pavarura të studentëve të KUB, të cilët përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e studentëve të KUB në të gjitha programet e studimit. Këshilli studentor shpreh mendime dhe propozime për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të universitetit, si për planet dhe programet e studimeve, rregulloret për veprimtaritë mësimore, të drejtën për të studiuar, cilësinë e shërbimeve, përcaktimin e tarifave të shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët, bilancet vjetore paraprake të shpenzimeve ose ndarjen e burimeve financiare, zhvillimin e veprimtarive të ndryshme kulturore, artistike, sportive etj. Në anëtarët e Senatit Akademik përfshihen dhe përfaqësues të studentëve, duke mundur në këtë mënyrë transmetimin e zërit të tyre

	në këtë organ drejtues si dhe pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje. (Neni 17 në Statutin e KUB). Në senatin akademik përfshihet një student. Gjithashtu përfaqësues të studentëve ka edhe në NJSBC. <i>Evidence: Dok 17 Statuti i KUB</i> <i>Evidence: Dok 26. Rregullore e NjsBC</i> <i>Evidence: Dok 78 Vendimi i Senatit për pjesëmarrjen si anëtar i Senatit i përfaqësuesit të studenteve</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	KUB/KSLP kanë garantuar përfshirjen e studentëve (përfaqësuesve të tyre) në organet vendimmarrëse, këshillat, etj. Gjithashtu studentët marrin pjesë në vlerësimin mbi procesin akademik, nëpërmjet pyetësorëve. Sipas rregulloreve të KUB dhe KSLP studentët shprehin vlerësimin e tyre për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të universitetit, nëpërmjet vlerësimeve semestrale ose vjetore që organizohen nga njësitë e sigurimit të cilësisë. Nga takimet në institucion me studentët, këto pyetësorë realizohen përpara provimeve dhe janë anonime duke shprehur mendimin real të tyre. KUB angazhon edhe entitete të pavarura, si IQE (Instituti për Cilësi në Edukim), për të realizuar pyetësorë dhe për të bërë vlerësimin e procesit mësimor, të vetë KUB-it dhe cilësië e shërbimit të stafit akademik. <i>Evidence: Dok 10 Rregullore e programit të studimit "Teknik i Lartë"</i> <i>Evidence: Dok 14. Rregullore e KSLP</i> <i>Evidence: Dok 15. Rregullore e DSLT</i> <i>Evidence: Dok 17 Statuti i KUB</i> <i>Evidence: Dok 18 Rregullore e KUB</i> <i>Evidence: Dok 51 Raport i NJSBC për vitin akademik 2023-2024</i> <i>Evidence: Dok 59 Pyetësor i studentëve dhe pedagogëve nga NjsBC</i> <i>Evidence: Dok. 31, Raporti i IQE</i> <i>Evidence: Dok.6 Urdhëri i Rektorit me nr.118, datë 26.02.2025 për ngritjen e GVB</i>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e	Pjesëmarrja e studentëve në organet vendimmarrëse të KUB bën të mundur marrjen e mendimit të tyre për programin e studimit. Gjithashtu, nëpërmjet pyetësorëve të vlerësimit të

hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	lëndës nga studentët tërhiqet, ndërmjet të tjerash, mendimi për elementë që kanë të bëjnë me përmirësimin e programit të studimit. Përpunimi i të dhënave të këtij pyetësori për çdo program studimi, i cili plotësohet në fund të çdo semestri, shërben si bazë për përmirësime të mëtejshme. Megjithatë, meqënëse programi i studimit akreditohet për herë të parë nuk ka patur përmirësime në kurrikulën e programit të studimit në dy vitet e fundit akademike. GVJ gjatë takimeve në institucion u informua se elementë të përmirësimit të programit të studimit janë integruar kryesisht në trajtën e përmirësimeve periodike të syllabuseve të lëndëve. <i>Evidence: Dok 14. Rregullore e KSLP</i> <i>Evidence: Dok 17 Statuti i KUB</i> <i>Evidence: Dok 18 Rregullore e KUB</i> <i>Evidence: Dok 29 Raporti Vjetor i KUB për vitin akademik 2023-2024 dhe Raporti semestrit parë 2024-2025</i> <i>Evidence: Dok 51 Raport i NJSBC për vitin akademik 2023-2024</i> <i>Evidence: Dok 59 Pyetësor i studentëve dhe pedagogëve nga NJSBC</i>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Në rregulloret e KUB, KSLP dhe Programit të Studimit janë të përcaktuar qartë mënyra e vlerësimit të studentëve për vlerësimin përfundimtar duke ju mundësuar dhënien e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. Vlerësimi përfundimtar i çdo kursi sipas rregullores së programit të studimit (Neni 13, pika 3) kryhet duke u bazuar në shumën e pikëve të grumbulluara gjatë zhvillimit të lëndës duke filluar nga vlerësimi i vazhduar, gjatë semestrit, ku studenti vlerësohet deri në 40% të pikëve, lidhur me frekuentimin, aktivizimin, testin ndërmjetës dhe detyra kursi. Ndërkohë që për provimin përfundimtar studenti do të vlerësohet deri në 60% të pikëve. Në Rregulloren e Programit të Studimit (Neni 16 dhe Neni 17) janë përcaktuar edhe rregullat e komunikimit të rezultatit të provimit me ID e çdo studenti, ose me email-in personal të tyre, si dhe përcaktohen rregullat për ankimimin e rezultatit. Në rregulloren për Provimet përcaktohet se studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit dhe vlerësimin. Ankesa i drejtohet me shkrim sekretarisë jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga dita e publikimit të rezultateve dhe trajtimi i

	ankesës kryhet sipas një procedure të mirëpërcaktuar në rregullore e cila shkon deri në një shikim eventual të tezës së provimit nëpërmjet një komisioni ad-hoc. <i>Dok 10 Rregullore e programit të studimit "Teknik i Lartë"</i> <i>Dok 27. Rregullore e provimeve</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - <i>KUB garanton përfshirjen dhe angazhimin e studentëve (përfaqësuesve të tyre) në organet vendimmarrëse dhe këshilluese, sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</i> - <i>Studentët në KUB janë të organizuar në Këshilla Studentore duke mundësuar shprehjen e mendimeve dhe paraqitjen e propozimeve për të gjitha problemet me interes të përgjithshëm të universitetit.</i> - <i>Pjesëmarrja e studentëve në organet vendimmarrëse të KUB si dhe përpunimi i pyetësorëve të vlerësimit të lëndës nga studentët bën të mundur marrjen e mendimit të tyre për programin e studimit</i> - <i>Elementë të përmirësimit të programit të studimit janë integruar kryesisht në trajtën e përmirësimeve periodike të syllabuseve të lëndëve.</i> - <i>Vlerësimi i kontrollit të dijeve, realizohet mbi bazën e procedurave e përcaktuara në rregulloret përkatëse të cilat garantojnë barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit. Studentëve u njihet e drejta e ankimit.</i> <i>GVJ vlerëson se KUB/KSLP/DSLTL përfshijnë dhe angazhojnë studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese. Gjithashtu studentët përfshihen në rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies, saktësisë dhe ndershmërisë në vlerësimin e dijeve dhe cilësisë së shërbimeve ndaj tyre.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga

studentët.	
Kriteret	Vlerësimi
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Në KUB funksionojnë njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve si: - Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK) - Sekretaria Mësimore ZSKK u ofron studentëve informacion dhe këshillim sipas kërkesave të tyre. Ndër shërbimet që u ofrohen studentëve nga kjo zyrë janë trajnimet, intervistat për mundësi punësimi, këshillime etj. Sekretaria mësimore është strukturë ndihmës akademike me karakter administrativ në nivel njësie kryesore dhe ka për mision funksionimin, organizimin dhe shërbimin ndaj studentëve dhe stafit akademik. Nga Sekretaria Mësimore e KSLP në KUB studentit i ofrohet informacion lidhur me: - procesin mësimor, - procesin e provimeve, - procesin e vlerësimit, - vërtetime të ndryshme, - listë notash, - evente, aktivitete, konferenca, leksione të hapura, aktivitete sportive e artistike, udhëtime etj. <i>Evidence: Dok 18 Rregullore e KUB</i> <i>Evidence: Dok 24 Rregullore e ZSKK (Zyra për Këshillim të Studentit dhe Karrierën)</i>
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	Në KUB, për informimin dhe ndihmën ndaj studentëve gjatë procesit mësimor veprojnë: - Zyra për Këshillim të Studentit dhe Karrierës' - Zyra Mësimore dhe e Kurrikulave, - Zyra e Marrëdhënieve me Publikun, - Koordinatorja, - Departamentet - Sekretariatë Mësimore. Këto struktura, sipas rregullores, ofrojnë këshillim, ndjekje të përparimit dhe mbështetje akademike gjatë gjithë programit të studimit. Një rol të rëndësishëm në informimin e studentëve luan dhe faqja zyrtare e KUB dhe Portali i KUB.

	<i>Evidence: Dok 14. Rregullore e KSLP</i> <i>Evidence: Dok 16. Organigrama e KUB</i> <i>Evidence: Dok 17 Statuti i KUB</i> <i>Evidence: Dok 18 Rregullore e KUB</i> <i>Evidence: Dok 24 Rregullore e ZSKK (Zyra për Këshillim të Studentit dhe Karrierën)</i>
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK) zhvillon procesin e këshillimit të karrierës, ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve, mban kontakte me të diplomuarit/Rrjetin Alumni, dhe krijon mundësi punësimi për studentët/ alumni, organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare, workshop-e dhe jep informacion dhe orientim për praktikën profesionale. Përveçse nga ZSKK, studentët informohen edhe nga sekretaria mësimore, por edhe nga stafi akademik mbi: - Programet e studimit, - Akreditimin e tyre, - Organizimin dhe kohëzgjatjen e studimeve, - Kryerjen e praktikës, - Për zgjedhjen e temës së diplomës dhe udhëheqësit përkatës për diplomën etj. <i>Evidence: Dok 21 Rregullore e Praktikës Profesionale</i> <i>Evidence: Dok 24 Rregullore e ZSKK (Zyra për Këshillim të Studentit dhe Karrierën)</i> <i>Evidence: Dok 57 Rregullorja e Sekretarisë</i> <i>Evidence: Dok 76 Guida e studentit</i>
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse	Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK) mban të dhëna për punësimet pas diplomimit. Gjithashtu ky sektor është struktura përgjegjëse që harton dhe raporton periodikisht në MASR të dhëna statistikore. Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK) mundëson: - Informimin e studentëve për mundësitë e punësimit (nëpërmjet postës elektronike si dhe nëpërmjet zhvillimit të takimeve informuese), - Zhvillimin e trajnimeve, - Mbajtjen e kontakteve me studentët e diplomuar, - Krijimin dhe përditësimin e të dhënave për punësimin e studentëve, - Hartimin e raporteve dhe statistikave dhe vënien në

	dispozicion të studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. <i>Evidence: Dok 24 Rregullore e ZSKK (Zyra për Këshillim të Studentit dhe Karrierën)</i>			
Konkluzione	GVJ konstaton se: - Në KUB funksionojnë njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve si Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK), Sekretaria Mësimore njësi të cilat janë shumë aktive dhe janë ndërtuar e funksionojnë në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. - Zyra e Studentit dhe Këshillimit të Karrierës (ZSKK) zhvillon procesin e këshillimit të karrierës, ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve, mban kontakte me të diplomuarit/Rrjetin Alumni dhe krijon mundësi punësimi për studentët alumnit, organizon aktivitete për studentët, trajnime, seminare, workshop-e, harton dhe raporton periodikisht në MAS të dhëna statistikore, orienton studentët për praktikant profesionale etj. GVJ vlerëson se KUB ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave. Këto njësi e ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët. Zyra e karrierës i ndjek studentët pas diplomimit, mban të dhëna mbi shkallën e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe informon organet e autoritetet drejtuese/ose politikëbërëse.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet	Nuk përmbushet
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter profesional në: “Teknik i Lartë me profile: “Sisteme Kompjuterike”, “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi”, “Grafik, Web dhe Multimedia Dizajn” ofruar nga Kolegji Universitar “I Biznesit”

Pikat e forta dhe afirmime

1. Departamenti i Studimeve të Larta Teknike ofron këtë programi studimi në bashkëpunim dhe klimë pozitive mes dekanit, përgjegjësit të departamentit, stafit akademik si edhe studentëve.
2. Personeli akademik i programit të studimit në mënyrë të vazhdueshme mbështet, orienon dhe instrukton studentët me qëllim realizimin e kompetencave të tyre formuese. Komunikimi student-pedagog, student-institucion është shumë efektiv.
3. Studentët janë pjesë e takimeve të vazhdueshme që realizohen në departament për shprehjen dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme që ato mund të kenë.
4. Përmbajtja e programit të studimit jep mundësi të mëtejshme punësimi të studentëve në përputhje me pritshmëritë dhe kërkesat e tregut të punës.
5. Departamenti i Studimeve të Larta Teknike vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë dhe reflektuar mendimin e studentëve.
6. Vlerësimi i lëndës është i vazhdueshëm dhe bazohet në frekuentimin, aktivizimin në aktivitetet mësimore dhe detyrat/projektet lëndore.

Pika të dobta

1. Vërehen pasaktësi, mungesa dhe mospërputhje ndërmjet disa procedurave, rregulloreve dhe praktikave të ndjekura institucionale. (*Standardi I.2 Kriteri 2, Standardi II.1 Kriteri 3 dhe Kriteri 6, Standardi II.2 Kriteri 1, Standardi II.3 Kriteri 4, Standardi II.5 Kriteri 1, Standardi III.V Kriteri 1, Standardi III.6 Kriteri 2*).

Rekomandime

1. Të azhurnohen të gjitha rregulloret institucionale sipas profileve të reja të Teknik i Lartë, përkatësisht “Sisteme Kompjuterike”, “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” dhe “Grafik, Web dhe Multimedia Dizajn”. (*Standardi I.1, Kriteri 3 & Standardi II.1, Kriteri 2,3, Standardi II.3, Kriteri 1 dhe Standardi III.V Kriteri 1*)
2. Të realizohen raporte periodike analitike të detajuara të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit specifikisht për programin e studimit Teknik i Lartë me profile

“Sisteme Kompjuterike”, “Teknologji Informacioni dhe Komunikimi” dhe “Grafik, Web dhe Multimedia Dizajn”. (Standardi I.2, Kriteri 4)

3. Profilet TIK dhe GWMD të reflektohen me klasifikimin/kodifikimin e programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane (VKM. 310, datë 11.05.2022). (Standardi II.1, Kriteri 7)
4. Përmbushja e Vendimit të MASR nr.418, datë 10.5.2017, pika 2.b.ii, për mbulimin e ngarkesës mësimore minimalisht 70% nga staf PAE. (Standardi II.2, Kriteri 1)
5. Të caktohet një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili do të jetë përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. (Standardi II.2, Kriteri 3)
6. Të rishikohet skema e korespondencës orë mësimore për kredit ECTS nga të gjithë instancat përgjegjëse të programit të studimit dhe Zyrën e Kurrikulës. (Standardi II.3, Kriteri 2)
7. Në planin mësimor krahas kolonës për “Leksione”, “Seminare” dhe “Laboratore”, të shtohet një kolonë për Praktikën Profesionale dhe tipologjinë e lëndës (A, B, C, D dhe E). (Standardi II.3, Kriteri 2)
8. Të përditësohet dhe citohet/referohet sipas një stili literatura e rekomanduar, të rakordohet mospërputhja e ngarkesës dhe/ose veprimtarive mësimore që reflektohen në syllabus-e me atë që është miratuar në planin mësimor, të rregullohet masa e frekuentimit të detyrueshëm të leksioneve dhe seminareve bazuar në rregulloret përkatëse dhe të parashikohet në to masa e frekuentimit të laboratoreve. (Standardi II.3, Kriteri 4)
9. Provim Formimi të kalojë orë individuale e studentit. (Standardi II.4, Kriteri 2)
10. Të punohet për rritjen e mobiliteteve në kuadër të bashkëpunimeve në projekte Erasmus+ që lidhen ngushtë me fushën e këtij programi studimi. (Standardi II.4, Kriteri 4)
11. Hartimi i një pakete të detajuar për Praktikën Profesionale specifikisht për programin e studimit bazuar në rregulloret institucionale të IAL. (Standardi II.4, Kriteri 6)
12. Unifikimi i Rregullores së Provimeve bazuar në rregulloret institucionale ku ajo mbështetet. (Standardi III.3, Kriteri 8)

Evaluation's conclusions for the professional study program " Senior Technician with profiles in Computer Systems, Information and Communication Technology, Graphic, Web and Multimedia Design " provided by the Higher Education Institution " University College of Business "

Strengths and affirmations

1. The Department of Higher Technical Studies delivers this study program within a framework of effective cooperation and a positive climate among the Dean, the Head of Department, the academic staff, and the students.
2. The academic staff of the study program continuously supports, guides, and instructs students with the aim of achieving their formative competencies. Communication between students and lecturers, as well as between students and the institution, is highly effective.
3. Students participate in regular departmental meetings organized to express and address various issues they may encounter.
4. The content of the study program provides further employment opportunities for students, in line with the expectations and requirements of the labor market.
5. The Department of Higher Technical Studies periodically evaluates and improves teaching methods and formats, incorporating and reflecting students' feedback.
6. Course assessment is continuous and is based on attendance, participation in learning activities, and completion of course assignments/projects.

Weaknesses

1. Certain inconsistencies, omissions, and discrepancies have been identified among institutional procedures, regulations, and practices. *(Standard I.2 Criterion 2; Standard II.1 Criteria 3 and 6; Standard II.2 Criterion 1; Standard II.3 Criterion 4; Standard II.5 Criterion 1; Standard III.5 Criterion 1; Standard III.6 Criterion 2).*

Recommendation

1. All institutional regulations should be updated in accordance with the new Higher Technical profiles, namely "Computer Systems," "Information and Communication Technology," and "Graphic, Web and Multimedia Design." *(Standard I.1, Criterion 3; Standard II.1, Criteria 2 and 3; Standard II.3, Criterion 1; and Standard III.5, Criterion 1)*
2. Periodic detailed analytical reports should be prepared regarding the outcomes and benefits derived from cooperation agreements, specifically for the Higher Technical study program with the profiles "Computer Systems," "Information and

Communication Technology,” and “Graphic, Web and Multimedia Design.”
(Standard I.2, Criterion 4)

3. The ICT and GWMD profiles should be aligned with the classification/codification of study programs according to national and European directives and guidelines (VKM. 310, dated 11.05.2022). (Standard II.1, Criterion 7)
4. Fulfillment of MASR nr.418, datë 10.5.2017, point 2.b.ii, regarding the requirement that at least 70% of the teaching load be covered by full-time academic staff (PAE). (Standard II.2, Criterion 1)
5. A person should be appointed to the role of Study Program Coordinator, who will be responsible for the progress and development of the program and its professional practices in accordance with its objectives. (Standard II.2, Criterion 3)
6. The correspondence scheme between teaching hours and ECTS credits should be reviewed by all responsible bodies of the study program and the Curriculum Office. (Standard II.3, Criterion 2)
7. In the study plan, alongside the columns for “Lectures,” “Seminars,” and “Laboratories,” an additional column should be added for “Professional Practice” and for the course typology (A, B, C, D, and E). (Standard II.3, Criterion 2)
8. The recommended literature should be updated and cited/referenced according to a unified style; inconsistencies between the workload and/or learning activities reflected in the syllabi and those approved in the study plan should be harmonized; the required attendance rate for lectures and seminars should be regulated based on the relevant institutional rules, and attendance requirements for laboratory sessions should also be defined therein. (Standard II.3, Criterion 4)
9. The Formation Exam should include individual student hours. (Standard II.4, Criterion 2)
10. Efforts should be made to increase mobility opportunities within the framework of Erasmus+ cooperation projects closely related to the field of this study program. (Standard II.4, Criterion 4)

Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL			X	
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X